

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XIX i botimit, nr. 224, Qershor 2022

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

DUKAGJINASIT NË LIDHJEN E PRIZRENIT 1878-10 QERSHOR 2022

2

Me 10 qershor 2022, ishte 144 vjetori i Lidhjes Shqiptare te Prizrenit, nje ngjarje e madhe për kombin Shqiptar, një nga ngjarjet me kulmore mbas Lidhjes se Lezhës, me 2 mars 1444, me ne krye Gjergj Kastriotin.

Në këtë Lidhje u përfaqësua dhe Shkodra, në mes tyre ishin edhe me tre delegatë me të drejtë vote ekzekutive për zonën e Dukagjinit, Mark Lula Vladaj i krahinës së Shalës, Marash Kola i krahinës së Shoshit dhe Gjekë Gegë i krahinës së Shllakut.

Për meritat patriotike të këtyre tre burrave, që përfaqësuan Dukagjinin në çdo vend për urti, ngjarje luftarake për Pavarësi e Liri, Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" i ka propozuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë, për ti dekoruar, me datën 21 prill 2022, mbështetur dhe nga Kryetari i Bashkisë Shkodër, zoti Bardh Spahia.



Delegatët e Shkodrës në Lidhjen e Prizrenit, me 10 qershor 1878. Në këmbë majtas është Gjekë Gega i Shllakut, djathtas është Mark Lula i Shalës dhe në mes Marash Kola i Shoshit

TATA KUKEL

(Për ata që nuk duan të harrojnë vuajtjet stërgjyshore)

Tatë e thërrisin gjithë rinia. Burrat e motit në çetë, çergë strugë, e argati i drejtoreshin: A je, si je Kukel Ndreu? Të lumtë goja, tu rritë ndera, të pleqnoftë djali e të tjera, si e lypte rendi i kuvendit. Tata Kukel kishte të gjitha okët e një kerçi, shtatin, urtësinë, fjalën e besën. Shtatin, krrabën, tërvezën dhe lahutën i ... nat si ai.

15



Deri kur do të mbesim peng e mendësive primitive dhe e së kaluarës?!

Duke lexuar thënien e shkrimtarit të madh Irlandez, Oscar Wilde, i cili theksonte: "Askush s' është aq i pasur sa të blejë të kaluarën e tij!". I thashë vetes, e bukur, me shumë domethënie, se jo në pak raste kanë bërë e bëjnë përpjekje të na marrin të kaluarën, madje pa asnjë shpërbllim, por shtrova pyetjen: Sa na shërben ne ky përcaktim i këtij shkrimtari, që ne ta kemi bazë për të ecur përpara?

Pata lexuar një thënie shumë interesante: "Në qoftë se e ardhmja e pemës dhe rritja e saj lart janë mbi tokë, rrënjët janë nën tokë. Kjo do të thotë se e ardhmja ushqehet nga e kaluara. Të mjerë ... nuk kultivojnë kujtimet ..."

10

PAS AT' GJERGJ FISHTËS E SHKRIMTARIT ISMAIL KADARE, NJË SHKODRAN NOMINOHET PËR ÇMIMIN "NÓBEL"

6

Akademia Evropiane e Arteve në Paris njofton së akademiku Mark Zadeja, anëtar i përjetshëm i Akademisë Evropiane të Arteve, fitues i medaljes së artë në konkursin ndërkombëtar të poezisë në Paris dhe fitues i titullit "Honoris Causa". Njofton: "Akademia evropiane e arteve në Paris është informuar ..."

Prof. as. dr. KOLË TAHIRI - bartës i vlerave qytetare e kontributit të shquar pedagogjik

13

Qysh në fillim dua të pohoj se me Profesorin jemi nga i njëjti fshat, lagjet tona komshi e vëllezër (Pjeternikaj e Vuknikaj); kemi pasur historikisht e kemi lidhje të mira familjare, kemi ndarë gëzimet e hidhërimet, duke ndihmuar e përkrahur njëri-tjetrin në përballet e vështirësive që krijon jeta. Ndonëse unë jam më i vogël më se një dekadë e Ai është larguar nga fshati qysh 10 vjeç, unë e njoh mirë jetën e peripecitë që ka kaluar; ...

PANAIR-2022

Në ditën e fëmijëve, datë. 1 qershor 2022, ditë e Mërkurë, nga ora 10. 00 deri në orën 12. 00, në shkollën "Dede Gjon Luli" Hot i Ri, u zhvillua një akveprimtari me temë "Panair" dhe me logon "Festojmë së bashku"

Në këtë veprimtari morën pjesë: Erjon Selgjakaj, Administrator i njësisë administrative Rrethina Bashkia Shkodër; Tome Marku, Administrator i njësisë administrative Pult Bashkia Shkodër; Ndue Sanaj, Kryetar i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" si dhe shumë ish-drejtuës e ish-mësues të kësaj shkolle ndër vite.

Në këtë veprimtari na nderuan me pjesëmarrjen e tyre edhe vëllezërit ... Shqiptare të Kosovës ...

4

DUKAGJINASIT NË LIDHJEN E PRIZRENIT

1878-10 QERSHOR 2022

Me 10 qershor 2022, ishte 144 vjetori i Lidhjes Shqiptare te Prizrenit, një ngjarje e madhe për kombin Shqiptar, një nga ngjarjet me kulmore mbas Lidhjes se Lezhës, me 2 mars 1444, me ne krye Gjergj Kastriotin.

Në këtë Lidhje u përfaqësua dhe Shkodra, në mes tyre ishin edhe me tre delegatë me të drejtë vote ekzekutive për zonën e Dukagjinit, Mark Lula Vladaj i krahinës së Shalës, Marash Kola i krahinës së Shoshit dhe Gjekë Gegë i krahinës së Shllakut.

Për meritat patriotike të këtyre tre burrave, që përfaqësuan Dukagjinin në çdo vend për urti, ngjarje luftarake për Pavarësi e Liri, Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" i ka propozuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë, për ti dekoruar, me datën 21 prill 2022, mbështetur dhe nga Kryetari i Bashkisë Shkodër, zoti Bardh Spahia.

Mark Lule Vladaj, jeta e vepra e tij të nderohet me urdhrin "Flamuri Kombëtar", pas vdekjes, me motivacion: "Për kontributin e shquar, aktet patriotike, trimërinë dhe guximin e treguar në mbrojtjen e çështjes kombëtare, si udhëheqës dhe luftëtar në përpjekjet për pavarësi dhe çlirim kombëtar"

Marash Kola i Shoshit dhe **Gjekë Gega** i Shllakut, jeta e vepra e tyre të nderohet me titullin "Kalorës i Urdhrit të Flamurit", pas vdekjes, me motivacion: "Për kontributin e shquar, trimërinë dhe guximin e treguar në mbrojtjen e çështjes kombëtare, si udhëheqës dhe luftëtar në përpjekjet për pavarësi dhe çlirim kombëtar"

KUSH ISHIN KËTA TË TRE ATDHETARE?



MARK LUL VLADAJ I KRAHINËS SË SHALËS

Mark Lula, lindi në Pecaj të Shalës, në Dukagjin të Shkodërs, i familjes se Vladit dhe i vllazënis së Pecnikës në vitin 1814-të. Ishte Bajraktar i parë i nëntë maleve të Dukagjinit, një burrë i kompletuar

me virtytet ma të mira të traditës sonë. Ai u rritë në një familje me tradita të shquera patriotike, në një ambient familjar ku gjatë historisë k'jo familje ishte e shquar për besë, burri e urti, për trimni dhe e gatëshme për mbrojtjen e maleve të Malësis dhe të atdheut Shqiptar. Si



Delegatët e Shkodrës në Lidhjen e Prizrenit, me 10 qershor 1878. Në këmbë majtas është Gjekë Gega i Shllakut, djathtas është Mark Lula i Shalës dhe në mes Marash Kola i Shoshit

familje në krye të fisit të Shalës, Mark Lula është shquar si prijës luftarak, për aftësi të rradha organizues dhe drejtuese të Dukagjinit në luftë kundër pushtuesve osman Turq.

Qyshë në moshë të re Mark Lula u vu në krye të udhëheqjes të kryengritësve të Dukagjinit. N'gjarjet që kishin n'dodhur në Kala (me heroizmin e pa shoqë të Shtatë Shaljanve ishin ala të freskta për pushtuesin Turk, ku Shala i tregoi Sulltanit, se me Shalën nuk bahet fjalë për bashkjetes, se vetëm pushka na n'da. (Marrë nga libri i Ndue Cukelit, "Mark Lula" kryeprijës i Dukagjinit, faqe 14-21).

Në mbrojtje të kufijëve, të Atdheut; Në vitin 1840 dhe 1874, perandoria Turke organizoj tre ekspedita të fuqishme për të nënshtruar Dukagjinin, por kryengritsit e Dukagjinit me në krye Mark Lulën, i bani që këto tri njesi ushtarake të përfundojnë në disfatë. Historia e kishte mësue se Evropa nuk na kishte mbështet dhe as nuk ishte përkrahëse e denjë për interesat tona Kombëtare Shqiptare. Nga k'jo arsye Marku ishte një nga përpiluesit e protestës që ju dërgue Kongresit të Berlinit, me 15 Qershor 1878, për kundër coptimit të tokave Shqiptare dhe aneksimit të Veriut, shovinistëve Serbo-Malazez. Bashkë me kryengritsit Dukagjinas, Mark Lula u vu në rradhë të parë të frontit në mbrojtjen e kufijëve dhe të Atdheut. Tu folë për trimnin dhe patriotizmin e Dukagjinit dhe prijësit të tyne, At Gjergj Fishta tek "Lahuta e Malcis", kënga e 16-të, thotë;

...Dymijë djem çoj Dukagjini, / N'luftë të rrëmbyeshëm pors Drini / Kah diktohet turbull zadhit, / Mjaft me i thanë

Shala mizore, / N'za për pushkë, k'jo, pushkën n'dorë, / Ai Mark Lula na u ka pri, / Kallushan musteqe zi, / Në log për mënd e për urti, / Për urti e për trimni, / N'kaçaturrë dhe n'adhti...

Delegat në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit;

Mbretit, / Tu n'gjatë jeta si kam thanë, / Unë kam ruejt gjuhën Shqiptare, / Unë kam mbajnt doke dhe Kanu, / As për pare e as për timare, / Gjak e të parë si kam mohu. / Prandaj Shkjau ne me na m'sy, / E me dalë k'nej nga Shqipnia, / Ka me u n'desh me armët e mija, / Me armë të Lekve të Dukagjinit, / E me n'dimën e perendis, / Kena me ja thye pleqnin Berlinit, / Kena me p'shtue lirin Shqipëris. / Pse po m'thua me u vra me Shkja, / Tu pas mbrënda Anadollakun, / Që kurr të keqen s'ma ka n'da, / Që kurr qafe s'ma hoqi lakun, / Që edhe zëmrën ma ka tha, / Ai m'ka mbytë tatë e nanë, / S'më ka lan djalë me u rritë n'votër, / M'ka marrë tokën e trashigueme, / M'ka korrë arën e punueme, / M'ka marrë qetë për nan lavër, / M'ka marrë lopë me gjithë viça, / M'ka marrë delet me oqiça, / M'ka marrë dhën e m'ka marrë dhi, / Edhe sot m'ka vnu leçi, / Mos me folë n'gjuhë t'parve t'mi, / ...Përse Krajlit edhe Mbreti, / Duen t'më mbajnë mue rob nan veti, / Unë luftoj veç për liri, / Për erz tëmin e për Shqipni, / Se unë t'huajin, se due zot në shpi, / S'due t'njof as Krajl as Mbret, / Mbret, Shqiptari asht në vënd të vet, / ...

Mirënjohje dhe Vlerësim

Ashtu si shumë figura të tjera të shquera të kombit Shqiptar, edhe figura e Mark Lulës nuk gjeti vlerësimin e duhur, ku ç'do titull që mund ti jepej, nuk mund të plotësonte madhësitin e tij.

Me ardhjen e demokracisë, (ku historia i kishte lenë në harres), dhe me propozim të krenve të Dukagjinit, Bashkia e Shkodërs, në pranver të vitit 1996, i dha një nga lagjeve të qytetit të Shkodërs emrin "Lagjia Mark Lula" tue e përjetue kështu, një nga figurat e mëdha të patriotizmit Shqiptar.

Shih edhe këtë:

Shtatë Shaljan, Mehmet Shpendi, Mikel Koliqi, Djelmnia e Shalës, Beteja e Qafës së Agrit, Dedë Gjo Luli, Marash Delia, Vat Gjeloshi, Martin Camaj, Dukagjini, Shala e Shkodrës, Abat, Thethi, Kiri, Pulti (krahinë), Nikaj e Mertur.

Lidhje të jashtme

Asnjë betej luftarake nuk mund të zhvillohej në veri të Shqipëris pa marrë pjesë trimat e Dukagjinit, dhe pa marrë pjesë Shala me në krye Mark Lulën. Ai mbante lidhje të vazhdueshme me patriotët të shquem dhe prijësa të luftës, siç ishin Mic Sokoli, Çun Mula, Sulejman Vokshi, Hodo Sokolin, Gjon Marka Gjonin, Prëng Bibë Dodën e të tjerë, ai i pati miq dhe shokë armatash dhe kuvëndesh, siç përshkruhet në shtypin e asaj kohe. Ai luftoj kundër Turqeve në vitin 1874, në mbrojtje të Plavës, Gucis dhe Ulqinit. Shkëlqeu si prijë popullorë në luftën e Miletit në Prill të vitit 1880. Në luftën për mbrojtjen e Hotit dhe Grudës, Çun Mula i drejtohet;

...Po ku je more Mark Lula, / Na ka ra Shkjau e na ka m'sy, / Malet kanë nevojë për ty,...

MARASH KOLA I KRAHINËS SË SHOSHIT

Marash Kola (1856-1910), Prijës i shquar i fisit luftarak të Shoshit njeri me karizëm deri në kufijtë e kultit për urtësi-



në, devocionin kanunor, mprehtësinë, dhe orientimet e drejta politike në lëvizjet patriotike të kohës që jetoj. Luftoi që i ri në krye të fisit të vet kundër turqve kundër me i 1874.

Ishte delegat i Lidhjes shqiptare të Prizrenit me të drejtë vote ekzekutive për zonën e Dukagjinit së bashku me Mark Lulën dhe Gjekë Gegë

Luftoi dhe për mbrojtjen e Plavës, Gucisë dhe Ulqinit, u dallua në Luftën e Miletit në prill 1880. ishte anëtarë aktiv Degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për Shkodrën së bashku me Hodo Sokolin, Mark Lulën dhe Gjekë Gegën.

Me 26 maj 1871 Pal Gjoka një luftëtarë i deklaruar anti osman nga fshati Gurre i Shoshit vrau Bylykbashin e Shkodrës Sulejman Agë Hotin së bashku e truporjen e tij në fshatin Kirë të krahinës së Pulit.

Porta e lartë në bashkëpunim Valiun e Shkodrës hakmerret në mënyrë të egër, duke internuar në Kerr Torobullus 24 krerëve të parisë së Shoshit mes të cilëve të identifikuar janë Marsh Kola Flamurtarë i Shoshit, Lulash Bala (vdekë atje), Prekë Ndou, (vdekë atje), Gjon Ndoka (vdekë atje), Nikë Marshi (vdekë atje), Gjon Pal Ndreu, (vdekë atje), Mirash Prela (vdekë atje), Gjon Pal Ndreu, (vdekë atje), Shytan Nika (vdekë atje), Gjon Pal Ndreu, (vdekë atje), Vuksan Lula, Ndue Mehilli, Nikë Mala, Ndoc Prela, Ndre Mash Nikolli, Marsh Ndue Alia, Mirash Ndou.

Marsh Kola ishte një nga pinjollët më popullor të Dinastisë së derës së bajraktarëve të Shoshit e kthyer në traditë shekullore udhëheqje dhe prijësi në ngjarjet politike më rëndësishme ndër kohëra të Dukagjinit.

GJEKË GEGAI KRAHINËS SË SHLLAKUT

Gjekë Gega ka lindur me 1835, në fshatin Gegaj të krahinës së Shllakut, është biri i këtij fshati, i cili që në formimin e fisit të Shllakut përmenden si një ndër fshatrat më burrë, që kane ruajtur

krahina e Shllakut.

Gegajt është fshati që kishte një shtrirje gjeografike të madhe, por nga një stuhi e madhe humbi një pjesë e madhe e tokës. Kështu fshati Gegaj kishte “Ceken e Shl-



lakut”, që ishte një sipërfaqe e konsiderueshme toke.

Gjekë Gega u dallua që në fëmijërinë e tij për zgjuarsin dhe trimërinë.

Gjekë Gega ishte prirës i Shllakut për lufte, ku dallohen si të parët e Shllakut dhe kishin statusin e parë të larjes së duarve në terveza e kuvende, që përfaqësonin krahinën e Shllakut.

Figurën e Gjekë Geges e ndeshim në botimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë në “Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912”, Tiranë 1978.

Shkodër 16 qershor 1878

Proteste e popullsisë të të gjithë krahinave të Shqipërisë së Mesme e Veriore si dhe të Tivarit, Triepshit, Tuxhemiles, Kuçit e të tjera drejtuar Kongresit të Berlinit kundër copëtimit të Shqipërisë. Ajo kërkonte respektimin e të drejtave kombëtare.

Shkëlqesa,

Traktati i Shën Stefanit, që mendohet se do të rishikohet nga qeveritë e mbledhura në Kongres, i akordon Malit të Zi, zmadhime në Shqipërinë e Veriut, do me thane, portet e Adriatikut e Tivarit dhe të Ulqinit së bashku kështjellat dhe pozicionet strategjike, si Podgorica dhe Shpuza, që kane qene gjithmonë të këtij vendi dhe që kane shërbyer, për tu mbrojtur kundër armikut.

Duke qene puna kështu, ne të nënshkruarit, në emër të të gjithë popullit, duke ju lutur të keni parasysh fatkeqësitë që kërcënojnë ekzistencën tonë, kemi nderin të shpallim se kombi shqiptarë qofte mysliman, qofte katolik, që ndryshon aq shumë prej sllave nga kombësia, ashtu dhe nga feja, është njëzëri i vendosur të mbroje atdheun e vet kundër ndarjes të territorit, që është projektuar, si një veprim që është në kundërshtim me historinë e tij, me interesat e tij dhe me dëshirat e tij.

Ne ju lutemi të mbronin tërësi-

në tonë kombëtare dhe territoriale dhe të na shpëtoni nga konfliktet shkatërrimtare, që do shpërthenin nëse do të behën aneksimet, që prekin Shqipërinë, të na hapin rrugën e zhvillimit që dëshirojnë të ndjekim dhe të na jepeni mundësi të ndiejmë ndikimin e dobishëm të qytetërimit. Në të njëjtën kohë marrim lejen të shprehim dëshirat tona, duke dërguar telegram me sa më shumë nënshkrime.

Nënshkruar nder të tjerët nga gjithë Shqipëria edhe Gjekë Gega, kaxhabash i Shllakut, Mark Lula i Shalës, Marash Kola i Shoshit ...

(PAAA, Turqia 129, vëllim i II; Aktet e kongresit të Berlinit, II, 1878, nr.33. Përkthyer nga origjinali frëngjisht, fq. 37).

Kështu, sipas dokumenteve arkivore vërtetohet se Gjekë Gega i Shllakut është delegat me të drejtë të plote vote, në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit.

Prizren, 2 korrik 1878

Programi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që synonte të ruaj tërësinë e tokave shqiptare, duke mos lejuar copëtimin e tyre nga shtetet shoviniste fqinje. Lidhja merre masa për organizimin e ushtrisë dhe dislokimin e saj në raste lufte. Mbasi e gjithë Shqipëria e Veriore e besë lidhur me Bosnjën, për të shpëtuar atdheun nga gjendja e vështirë e sotme zgjodhi Prizrenin, si seli qendrore të lidhjes dhe mbasi deputet e sanxhakut të Prizrenit, Dibërës, Manastirit, Shkopit, Prishtinës dhe Novipazarit u mblodhën këtu, në baze të nenit 3 të vendimeve të marre për këtë rast, që lejon shprehimisht pranimin në Lidhje edhe sanxhakëve dhe të rrethëve të tjera, pa u dorëzohet deputeteve të ardhur nga Shkodra.

Nga informacioni i datës 1 korrik 1878, që drejtuesi i konsullatës së Francës në Shkodër, Poni i dërgon Vadingtonit, Ministrin të Jashtëm të Francës, del se në mbledhjen e Komitetit Kombëtar, në Prizren kishin marre pjesë këto delegat nga Shqipëria e Veriore dhe e Mesme...

Mark Lula i Shalës, Marash Kola i Shoshit... Gjekë Gega-vojvode i Shllakut... (AMAE, CPC, konsullata e Shkodrës, vëllimi 21, fl. 159 rv). Po këtu, faqe 57.

Siç shihet dukeshim në aktet të Rilindjes Kombëtare Gjekë Gega përfaqësonte krahinën e Shllakut dhe ishte një aktor i fuqishëm me ndikim të madhe në popull, ku ishte në krah të burrave nga

të gjitha trojet shqiptare në mbrojtjen e kombit Shqiptarë.

t Gjergj Fishta tek “Lahuta e malësisë”, në vargun e tij ndaj figurave të kombit rrallit dhe Gjekë Gegën e Shllakut. Ku portreti i tij prej luftëtari është përmendur disa here.

Ja disa vargje prej këngës thurur për Gjekën:

Prap prej Shllakut lshon Gjegë Gega: / Faqja e tij kuq porsi shega : / Shllungë mustakun derdhë n’dy dega: / Kur një fjalë po e folka burri, / Mâ s’ i luejtka me sa curri. / Ktij Gjet Geges po i lshon bër: / Pâsh njat Zot, qi të kâ dhânë, / Deli, Gjeto, n’ mûjsh, m’ at ânë, / Edhë nzite m’ patershânë, / Tuj i a ngulë m’ ndonjë’ n germaz; / Pse un ktej gati m’ shaterkaz / Po t’ i rri ktej mbrapa shpinës, / N’ mûjsha í herë me i rà kaptinës / . Edhë trût m’ i a derdhë per tokë. / Gjeto Gega shpejt kâ rrokë / Heshten, trashë sa ‘i « mashkull » qerrit, / Edhë shi rrânzë njëj kapzherrit / I a kâ ngulë, po, nja tri pl lamë. / Bân kulshedra me u çue m’ kâmë, / Bân me u rraqsun vithambrapa,...

Gjekë Gega ishte personi që i printe Shllakut në çdo betejë ndaj pushtuesve. Dallohej për autoritetin që gëzonte në popull ku merrte pjesë në shumë betejë kur atdheu rrezikohej nga pushtuesit. Me 300 luftëtarë nga krahina e Shllakut mori pjesë në luftën ndaj pushtuesit malazez me krerët e të gjithë fiseve të Dukagjinit e Malësisë së Madhe. Autoriteti i kësaj figure të dashur popullore respektohej kudo, ku në krye të Shllakut ka merita të mëdha si luftëtar e pajtimtar.

Gegaj nderohet dhe këndohet në çdo trevezë e mbledhje për urtësinë e burrërinë që gëzonte në të gjithë krahinën. Kështu vendi i parë në Shllak i përket Gegajve. Familja e Gjekë Geges është transferuar në Bardhaj. Trupi i pa jete i këtij simboli të Shllakut prehen në varret e fshatit Bardhaj.

**Sokol Dedndreaj, Kole Vladaj,
Gjin Dedndreaj, Prele Milani,
Zef Nika, Ndoc Prendushi
e Mark Gjeka**

REDAKSIA



PANAIR-2022

Në ditën e fëmijëve, datë. 1 qershor 2022, ditë e Mërkurë, nga ora 10. 00 deri ne oren 12. 00, në shkollën “Dede Gjon Luli” Hot i Ri, u zhvillua një akveprimtari me temë “Panair “ dhe me logon “Festojmë së bashku”

Në këtë veprimtari morën pjesë:

Erjon Selgjakaj, Administrator i njësisë administrative Rrethina Bashkia Shkodër;

Tome Marku, Administrator i njësisë administrative Pult Bashkia Shkodër;

Ndue Sanaj , Kryetar i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” si dhe shumë ish-drejtues e ish-mësues të kësaj shkolle ndër vite.

Në këtë veprimtari na nderuan me pjesëmarrjen e tyre edhe vëllezërit nga trevat Shqipetare të Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut:

Rahman Jashari, Kryetar i Sindikatave të bashkuara të Arsimit të republikës së Kosovës;

Ukshin Jashari, Kryetar i Shoqatës Vllazërimit Kosovë-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj“, me qender në Pejë.

Vullnet Sadiku, Kryetar i Shoqatës së shkrimtarëve “ABC” Maqedonia e Veriut;

Blendor Shatri, veprimtar i lartë i “SBASHK” në republikën e Kosovës;

Kumrie Shala, Shkrimtare (Pöete) nga Peja;

Venera Shoshka veprimtare e shoqatës “Vllazërim e bashkim Martin Dreshaj “ Pejë.

Panairi në përmbajtjen e tij kishte:

Punimet artistike (zeje) të nxënësve.

Këto punime janë bërë nga nxënësit në bashkëpunim me mësuesit përkatës së qëndrës komunitare. Nxënësit kanë punuar me durim, pasion e përkushtim për raelizimin e këtyre objekteve artistike ku spikat shumëllojshmëria e tyre.

Gatime dhe prodhime të zonës. Gatimet e shumëllojshme nga amvisat e zonës, i dhanë “shijen” e vet kësaj veprimtarie.

Kjo veprimtari u përshendet me një koncert i organizuar nga grupi artistik i shkollës, ku morën pjesë:

Më të vegjëlit, me pjesë të përzgjedhura nga Festa e Abetares.

Nxënës të klasave të ndryshme me këngë e recitime

Grupi i valles me veshje tradicionale, të punuara me dorë nga mësueset tona.

Pas fjalës përshëndetëse të drejtorit të shkollës, u shpërndanë disa certifikata mirënjohjeje për disa nga të ftuarit, që ndër to mund të përmendim:

Rahman Jasharaj, me motivacionin “Për kontributin e dhënë për arsimin Kosovë – Shqipëri dhe mbështetjen e vazhdueshme për shkollën tonë”.

Kolë Çardaku, ish-drejtues i shkollës sonë, me motivacionin “Për kontributin e dhënë në grubullimin e të dhënave për hartimin e historikut të shkollës dhe të fshatit Hot i Ri”.

Roza Pjetri, aktiviste e bashkësisë, me motivacion: “Për mbështetjen e vazhdueshme të shkollës sonë, e cila dha një kontribut të madh për pasurimin e

muzeut”.

Organizata “World Vision”, me motivacionin: “Për kontributin dhe mbështetjen e vazhdueshme në veprimtaritë e organizuara në shkollën tonë”.

Jasmina Bajraktari, mësuese e shkollës

sonë, me motivacionin: “Aktorja kryesore si mësuese drejtuese e projektit “Shkollat e sheullit XXI”, ku shkolla jonë u vlerësua me çmimin e parë në nivel kombëtar”.

Marin dhe Daniel Dedvukaj, nxënës me motivacionin: “Aktor kryesor në projektin “Bashkësia ime” në konkursin kombëtar “Shkollat e shekulli XXI””

Pjesëmarrësit u ftuan të vizitojnë muzeun, i cili u hap për herë të parë në këtë ditë feste. Shumëllojshmëria e objekteve të vjetra të paraqitura në muze, u

panë me shumë kureshtje nga vizitorët , të cilët lanë edhe mbresat e tyre në librin e përshtypjeve. Pas kësaj për të gjithë të pranishmit ishte organizuar një koktejl me mbështetjen e shoqatës “World Vision”.

Veprimtari të tilla si kjo, përmirësojnë klimën në shkollë dhe ndikojnë në përmirësimin e arritjeve të nxënësve .

Mësuese Jehona Quku



JU LUMTË ZOTI KRAHËT VEÇ MOS HARRONI SHKËMBIN E THETHIT!!!

(Të kapesht Nderlysen për një orë e gjysme nga Shkodra ishte ëndrra e jetës së këtyre maleve)

Isha duke udhëtuar nga Nderlysa drejt Thethit në një cak i them shoferit, mbaje pak se dua të bëj një foto. Po këtu sikur nuk është i plotësisht i përshtatur vendi; foli djaloshti ynë merakli e i pasionuar i fotografimit.

- Është plotësisht i përshtatshëm vendi që dua iu përgjigja! Makina u ndal, më pas u s'postua pak dhe unë bëra dy tre shkrepje. Pak më përtej po punonin disa murator. Një nga tekniket e punimeve mu drejtua pak sa i ndruajtur. -Shef a lejoni kënd t'u filmojë në punën tuaj?! Edhe po edhe jo i thash, por mos u bën merak se

ka edhe foto për mirë. Unë vijova rrugën, por e pashe që nuk i erdhi mirë pozimi i punës nga ana ime. Sot po publikoj këtë shkrim bashkë me foton time amatore, që këtyre punëtorëve të mirë, të cilëve edhe dikush tjetër për së largu mund tu thotë -"Ju lumshin krahët!"

Dita e mirë duket që në mëngjes.

Lëvizjet e shpeshta për arsye pune më kanë detyruar të jem dëshmitare i punimeve të rrugës qafë Thore -Theth nga kaza e pare deri në përfundim. Siç e kam thënë e publikuar disa herë pritshmërie dhe mundësitë kanë qenë shumë, shume të larta. Ka 3-4 muaj që po punohet në sektorin Theth Nderlysa.

Gati për ditë kalojmë andej, dhe për ditë u themi punueseve: A po lodheni? Ju

lumtë! Jepni burra edhe pak se erdhi valika e Verës e të tjera.

Nuk kisha pritshmëri se do bëhej ndonjë shkapërcim cilësor në raport me pjesën eprorë të nusëruar me çorape të grisura. Do që pritshmëritë dhe u tejkalu-



an. Ndaj ju lumtë muratorëve, teknikëve dhe sipërmarrësit, për punën e mirë, që kanë bere dhe po bëjnë.

Natyrisht kjo është një firmë tjetër, me sa di unë, me buxhet më të vogël, se ajo që shkoj duke lanë pas shkele -shkotë.

Jo më kot populli ka përfrazuar se mjeshtëri i mirë nuk e prishë dorën edhe kurrë nuk merr sa duhet hakun që i takon. Po bëhen mure mbrojtëse të sigurt, (jo mini funde plastike rruc puce), punimet duken shumë të mbara veç mos harroni shkëmbin e Thethit.

Të kapesht nga Shkodra Nderlysen për një orë gjysme, është ëndrra e jetës së këtyre maleve hirplote të mbuluar nga izolimi natyrorë

Prele Milani

Dukagjini 2012

"Dukagjini 2012", i autoreve Luigj Shyti e Zef Lulash Sokoli

Fjala Dukagjin nuk është e panjohur për Ju as për ne, nuk është as komune as fshat as qytet por një hapësirë gjeografike, dikur ishte mjaft e madhe, Principate

Dukagjinasi janë njerëz patriot, atdhetare, trima, gjakxehte, por edhe shumë artdashës.

Ketë, për këtu në Kosove e dini për në Shkodër po jua

konkretizoj me një shembull: "Në fillim të shekullit të kaluar, në Shkodër botoheshin 23 gazeta të pavarura, sot botohet vetëm gazeta "Dukagjini", me 20 vite jetë. Pjesën artdashës po e pasuroj me një tjetër argument: Vetëm Shoqata Jone ka promovuar rreth 73 libra të zhanre të ndryshëm dhe ka organizuar e zhvilluar 9 simpoziume shkencore...

z. Luigj Shyti është një emër i njohur i fushës të letrave në qytetin e Shkodrës. Poet, publicist, studiues e kryeredaktori i gazetës "Dukagjini", një veprimtar shoqërorë, me mbi 50 vite punë. Ka botuar disa libra, ky është libri i 10-te, por ka edhe angazhime të vijueshme në shtypin e shkruar dhe atë mediatik, pa përmend fotografinë, që po ja klasifikoj tek pasionet.

Botimet e tij janë:

1. Dukagjini rrugëtim në gjeneze
2. Gjurmë Syzime Etnografike në Dukagjin
3. Historiku i Arsimit dhe Kulturës në Dukagjin
4. Dukagjini ka vend për të gjithë (Publicistike)

5. Duaje emrin tënd (publicistike)

6. Moj e mira në ortek të borës (me kënge të buta)

7. Lamtumire mo's më thuj-poezi.

8. Etje-poezi

9. Fjalë të radha, fjalë të urta dhe shprehje popullore në Dukagjin

10. Dukagjini-2012

Tani do të bëj një paraqitje për librin e kolegut tonë që në rastin konkret vjen si bashke autor me të ndjerin Zef Lulash Sokoli, që shume nga ju e keni njohur, një

burrë fisnik, tipik i burrave të maleve.

Cilat janë veçoritë apo risitë e këtij botimi?

Libri, që sot po paraqesim, në Pejë, është i veçantë në llojin e tij, është libër statistikor-që mund ta quajmë, studim shkencor të demografisë për zonën e Dukagjinit. Është si një enciklopedi ose si një datares për banoret me origjinë nga Dukagjini, por edhe për studiues apo historiane të fushës.

Libri për mendimin tim është një veper, që nuk është për përdorim popullor, shpesh edhe për një poezi themi është si pikturat moderne. Mendoj se edhe ky libër vlen më shumë për studiues, historian, student apo persona që përgatit tema



Ndue Sanaj e Lulash Brigja, duke prezantuar librin "Dukagjini-2012", të autorit Luigj Shyti e Zef Lulash Sokoli

shkencore në këto fusha.

Ne Shqiptarët kemi kujtesë jo të mirë, kemi trashëguar pak dokument të shkruar, prandaj në faqen e pare autori thekson: "Le të jetë një pengese në rrugëtimin tuaj të harresës!" Duket paradoks, por nuk din si quhej baba i gjyshit, mire dje s'kishte kushte, ndërsa sot ka grithsha, por s' ka interes.

Libri përfshin një studim të pemës gjetetike të banoreve të krahinës së Shalës,

Shoshit dhe Pultit, që banorët e sotëm të zonës së Dukagjinit shkojnë nga 16 deri 19 breza

Në librat e tij në përgjithësi, por kryesisht tek studimi "Dukagjini në rrugëtim në gjeneze", autori ka kishte trajtuar prejardhje fise dhe të dokeve. Ndërsa në këtë studim është marr vetëm me banorët dhe si pikënisje ka marrë Defterin e Regjistrat të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485.

Ne këtë studim autoret kanë përfshirë 7352 familje ose një popullsi prej 12 000 banore.

Një veçori tjetër është evidenca e origjinës dhe vendbanimin aktual për të gjithë këta banorë. Krahasuar kjo me këtu, është sikur të bësh një statistike për të gjithë banorët që jetonin në Rugovë në 1980 dhe vendbanimin aktual që kanë sot.

Autoret kane marre si pikënisje vitin 1990, kur në këtë territor kishte rreth 12 mijë banore.

merrem as me faqosjen, as me shkallën e larte apo të ulte të përdorimit të figurave letrare).

Sa i vlefshëm është për një lexues banorë të Shkodrës apo të Dukagjinit?

Tek ku libër një banore, që ka lindur në vitet 1985 apo deri 1995, që prindërit e tij janë largua ose janë emigrant, ai mundet me gjet ku e ka pas vendlindjen, kushërinjtë e pare edhe ma gjate ka informacion për daja teze dhe të afërm të tjerë.

Sa i vlefshëm është për një poet, historian, studiues të toponimisë apo të leksikologjisë?

Sa i vlefshëm mund të jetë për Ju të pranishëm, për një profesor apo poet, që jeton këtu?

Përveç mbiemër, që mund të jene toponime, përveç krahasimeve statistikor demografike dhe produkte që dalin nga studimi i tyre.

Unë po marr një shembull historik, nga 1357 banore në vitin 1485, ose nga 3700 në vitin 1772, gjysma i bije të kenë qenë meshkuj, se jemi në kohen e vendosjes të sundimit absolut otoman. Mendo sa largua për jetese apo mbijetese. Vetëm një fakt, një mbiemër i marre nga ky libër apo nga libri "Dukagjini, në rrugëtim në gjeneze" po nga L. Shyti mundeni me gjet origjinën e ndonjë banori.

Ta konkretizoj: Uliçaj në Nderlysa, ka me këtë mbiemër diku këtu?! Ose Bojaj, në Bruçaj e të tjerë.

Sa vlen për Ju dhe për auditorin ky libër dhe ky promovim?

Këtu besoj se, jam në mundësinë me dhanë një opinion vetëm personal, i bindur se për auditorin është kënaqësi dhe vlerësim ta sjell punën e tij para një lexuesi kaq të kualifikuar dhe profesional.

Për Ju shpresoj që të keni krijuar një ide më të plote për Zotin Luigj, si poet, publicist dhe studiues edhe ta keni si nxitje për një studim të ngjashëm këtu.

Uroj që me ato sa thash dhe sa komentova të kem bere një pasqyre reale të vlerave të librit.

Faleminderit për vëmendjen dhe mundësinë të referoj në një ambient kaq poetik.

Lulash Brigja
Pejë, Maj 2022

PAS AT' GJERGJ FISHTËS E SHKRIMTARIT ISMAIL KADARE, NJË SHKODRAN NOMINOHET PËR ÇMIMIN "NOBEL"

Akademia Evropiane e Arteve në Paris njofton së akademiku Mark Zadeja, anëtar i përgjeshëm i Akademisë Evropiane të Arteve, fitues i medaljes së artë në konkursin ndërkombëtar të poezisë në Paris dhe fitues i titullit "Honoris Causa". Njofton: "Akademia evropiane e arteve në Paris është informuar lidhur me aktivitetin e komitetit kombëtar shqiptar ku, ju sot promovoni botimin me të ri "Qyteti i Vuajtjes". Prandaj në emër të akademisë evropiane të arteve, në emër të komitetit kombëtar shqiptar, si dhe në emrin tim personal, ju urojmë suksese të larta në fushën e letërsisë kombëtare që kontribuon thellimit të mesazhit për paqe në botë. Ju po e plotësoni bashke me kolegët tuaj botimin e letërsisë në nivelin më të lartë botëror. Me këtë rast ju uroj në emër të gjithë kolegeve tonë të akademisë suksese të larta, shëndet dhe jetë të gjatë. Kontributi juaj po e begaton historinë e të gjithë gjinive artistike.

Z. Mark Zadeja! Ju jeni kandidat potencial për çmimin më të lartë të paqes-Nobelist. Urime e suksese në këtë fushë!

Kryetari i komitetit kombëtar të akademisë të arteve, akademiku evropian dhe kryetar i seksionit shqiptar, Jetullah Halili", Paris .datë.10 maj 2022

Shkodra përgjatë shekujve në vijimësi ka nxjerrë nga gjiri i saj personalitete të nivelit të lartë dhe me cilësi të rralla, të cilët kanë lënë emër që në qytetërimin e hershëm dhe jo vetëm në atë evropian por deri në Azinë e largët. Mbretër, strateg e guvernator, personalitete të shkencës, kulturës dhe sportit. Ky burim nuk ka shteruar asnjëherë deri në ditët e sotme. Jo rastësisht Shkodra është quajtur djepi i artit dhe i kulturës kombëtare. Plot 85 vjet më parë, Atë Gjergj Fishta ishte shqiptari i parë, i cili nominohet nga Nobeli Suedez, 36 vjet pas krijimeve të tij. Duhej të kalonin shumë vite kur Ismail Kadare të bëhej shqiptari i dytë i nominuar për këtë çmim, për çmimin NOBEL; ndërsa sot është një tjetër personazh nga Shkodra i nominuar për këtë çmim të lartë, por e veçanta është së propozimi vjen nga Akademia e Arteve në Paris. Urojmë dhe shpresojmë së kjo e treta, të dalin e vërteta. Për qarqet akademike Parisian, akademiku Mark Zadeja është i njohur, (mua më pëlqen ta quaj Shkodrano-Gjermani), pasi ka mbrojtur studimin "Mbrojtja kundër rrezeve atomike", për shumë vite ka studiuar për filozofi. Marku është anëtar i përgjeshëm i Akademisë Evropiane të Arteve. Shquhet si specialist dhe vlerësues i Artit të Vjetër, njohës dhe kritik i artit bashkëkohor. Ndërsa kohë më parë është edhe fitues i çmimit "Honoris Causa".

Kush është akademiku e filozofi Mark Zadeja?

Në fillim të herës u ndjeva mirë me veten, që sapo më lindi ideja për të shkruar, për ish kolegun tim me profesion mjek-stomatolog. Një vit më parë sapo pati promovuar librin "Kole Idromeno" jeta dhe vepra. Mirëpo modestia që e karakterizon Markun më pengoi të shkru-

aj për te, ndërsa tani nuk dua të mbetëm peng i modestisë së tij. Ky është djali i një familje të moçme shkodrane, i lindur dhe i rritur në rrugën "Badra" të lagjes "Lekaj", siç quhej dikur, më vonë lagja "Perlat Rexhepi".

Ishte një vendbanim me familje elitash, të cilat qëndronin në krye të ajkës shkodrane, dhe më gjerë. I lindur me fat në këtë mjedis, përkujdesja e prindërve dhe në mënyrë të jashtëzakonshme e katër motrave për vllaun e vetëm, nuk kishte asnjë krahasim. Sapo fillon mësimet në shkollën 8-vjeçare "Vasil Shanto", bie në sy për një inteligjencë, e cila nuk përputhej me moshën, duke tejkaluar atë dhe duke rritur nivelin deri në mbarimin e gjimnazit "Ali Laçaj", në vitin 1965. Për çdo të ri në edukimin dhe formimin e tij të personalitetit përveç ambientit familjar dhe të afërmeve, një rol të veçantë luajnë rrethi shoqëror e në veçanti familjet që e rrethojnë, aq më tepër kur marrëdhëniet janë të ngushta. Ky fat i takon Mark Zadejes. Shtëpia e tij "kurthohej" në të gjitha drejtimet me familje, të cilat kishin lindur në vijimësi personalitete të shquara të elitës bashkëkohore shkodrane, shqiptare dhe shumë më gjerë. Ngjante sikur këto familje ishin vendosur si me dorën e Zotit. Të jetosh pranë familjeve me emër të veçantë, si ato të Kole Idromenos, Simon Rrotës, Gurakuqëve, Boriçëve, Atë Patër Mëshkalles, Mons. Zef Simonit, Patër Frano Kirit, Luigj Kçirës, familjes Saraçi-Mulleti e deri tek të afërmit e tyre Dom Ndre Zadeja dhe Çesk Zadeja, të duket sikur jeta nuk ka të sosur. Këtë mjedis, apo rreth shoqëror, quaje si të duash, çdo njëri do ta

fotografisë dhe të letërsisë bashkëkohore.

Fale bashkëpunimit dhe marrëdhënive të ndërsjella me këto figura ka bërë që në koleksionin privat të familjes Zadeja të jenë të arkivuara objekte të rralla artistike nga këto personalitete Kombëtare. Kjo i bie sikur të sfidosh edhe muzeume e galeri të veprave të rralla të ar-



Akademik Mark Zadeja! I nominuar për "Nobel"

tit klasik. Fati të buzëqesh të disponosh në koleksionin personal piktorë e spikator filozofike "Gjakmarrja" vepër origjinale, e cila tingëllon aq aktuale edhe në ditët e sotme, e cila ka moshën 130-vjeçare, apo skulpturën e "Jezusit" në dru, bust. Vepra këto të të madhit Idromeno. Duke marrë shkas nga dy argumente, së pari nga lidhja dhe bashkëpunimi i gjyshit të Markut me Idromenon, për të cilën ai i ka kushtuar li-

Vepra në pikurë "Gjakmarrja" e vitit 1892 është një punim i veçantë në shumë drejtime. Përveç kombinimit dhe harmonizimit të ngjyrave, është ana ideo-artistike e filozofike, të cilat të magjepsin. Me këtë vepër u organizua një ekspeditë në të gjithë Dukagjinin, duke veçuar sidomos ato zona ku gjakmarrja ishte më e evidente.

Autori Kole Idromeno shoqërohej nga një famullitar dhe Lazër Zadeja (gjyshi i Markut). Kjo ekspeditë e veçantë në llojin e vet pati një impakt të jashtëzakonshëm në "zonat e nxehta", duke kryer funksionin e një misioni të paqes. Kjo tregonte në mënyrë më bindëse së familjet në gjak të ngjuara nuk mund të kenë zgjidhje në qoftë se gjakmarrja vazhdon. Vepra tregon së të drejtën për të jetuar e ka çdo njëri. Kush mendon për gjakmarrje i shërben të keqit, ky ishte lajtmotivi. Në koleksionin personal të akademikut Zadeja përfshihet portreti i Leze Sakatës. Një grua shkodranë me paraqitje mahnitëse, vepër kjo e realizuar nga Ernest Koliqi. Ndër objektet e veçanta gjenden edhe gjërat personale të At' Gjergj Fishtës siç janë stilografi dhe gjyzykët. Ndër këto objekte të koleksionit qëndron edhe "Ungjilli i Martin Luther Kingut", botim i vitit 1556.

Këto vepra dhe objekte të veçanta, përveç rëndësisë, për me tepër së gjysmë shekulli kanë mbartur me vete edhe rrezikun permanent nga regjimi, i cili kërkonte të futej në çdo detaj të jetës njerëzore. Por përkujdesja në shkallë superiore e familjes Zadeja qëndronte mbi lartësinë e vëzhgimit të sigurimit të shtetit. Këto vepra ndikuan edhe në formimin e Markut si intelektual. Për të ilustruar këtë mjafton



Pjesëmarrësit në promovimin e librit, me titull "Qyteti i Vuajtjeve"

kishte ëndërr. Duke pasur pranë kualitete të spikatora si, arkitekt e urbanist të nivelit evropian, personalitete të besimit fetar, të piktorës e skulpturës, dramaturgjisë e

brin "Kolë Idromeno", jeta dhe vepra, dhe së dyti, nisur nga impakti që ka pasur kjo pikurë në publik sapo ishte realizuar, dua të ndalem pak për jehonën e saj.

të citoj një shprehje nga ato të rinisë së tij të hershme, e cila thotë: "Pika më e lartë e njerëzimit ka qenë dhe mbetet arti, sepse ai formon njeriun". Duke pasur prirje

Këngëtari Pëllumb Vatnikaj

Me datë 28 Maj 2022, dite e Shtune, u mbajt koncerti recital “Zani i Bjeshkëve”. i këngëtarit Pëllumb Vatnikaj

Në ambientet e Art Center “Blue Sky” një sallë gjigande e ideuar për spektakël muzikore..

Pas 10 vitesh në amfiteatrin me gladiator të muzikës folklorike, pas 5 vite punë dhe suksese në Amerikën e largët, Pëllumb Vatnikaj vinte si triumfator në Shkodrën, që u rrit për të ngritur Flamurin e Suksesit.

Në vitet e fundit ka promovuar shumë Hite folklorike. Dikush thotë se ishte djalë me fat, dikush tjetër beson se ka vërtet talent. Ndoshta ka ndikuar zgjedhja e bashkëpunëtorëve apo mbështetja e miqve të Tij . Sido që të jetë një gjë është e dukshme, Vatnikaj e shkroi emrin si Luan i fuqishëm i skenës dhe ekranit të muzikës folklorike, aq sa “ujqit e vjetër” të kësaj fushe kane filluar ta shohin me xheloz.

Recitali kishte dy “dirigjente” të sprouar të spektaklit. Gëzim e Mimoza Brahusa, të cilët nen logon e “TV BLUE SKY” i dhanë nota artistike libretit të përgatitur nga aktori dhe poeti Qazim Çela.

Moderatorja: Adelajda Tukaj me sharmë dhe elegancë kopsiti tre orë spektakël.

Shoqata “Besa Shosh” përshëndeti me një kënge enkas për këtë Recital, me titull “MIRESE VJEN O PLLUM VATNIKAJ”

Pastaj në emër Shoqatës Atdhetare Dukagjini z. Luigj Shyti i dorëzoi titullin “NDERI I SHOQATËS ATDHETARE DUKAGJINI”, me motivacion: “Për kontributin tuaj disa vjeçar në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore folklorike të Dukagjinit; për vlerat e larta artistike dhe mesazhin e dashurisë që përcjellin këngët e tuaja për vendlindjen; për imazhin e shkëlqyer si ambasadori i traditave tona, në vendin ku jetoni”

Ne emër të Njësisë Administrative “LeNikaj-Merturi”, z. Ndue Gjergji i dha “Mirënjohje”, me motivacion: “Për kontributin në promovimin e vlerave tradicionale folklorike”.

Presidenti i TV “Blue Sky”, z. G. Brahusa e vlerësoj me titullin “Krenaria e Ekranit tonë”.

Nga 10 këngët që u prezantuan 7 ishin me tekste të Lulash Brigjes, 4 prej tyre ishin premiere ndaj e ndoqa me emocion çdo detaj të kësaj ngjarje të madhe për Pëllumbin.

Një tjetër ngjyre i dha spektaklit prezenca e këngëtareve Zef Beka e Flora Gashi; Arben Gjeloşi e Gofile Papekaj; Ansambli i valleve “Dardania”, dhe Ansambli Autokton “Rugova”; çaste gazmore nga aktori i humorit. Gac Kodrina.

Unë e di vlerën dhe e çmoj bujarin e çdo sponsori që mbështet artin dhe kulturën ndaj do falënderoj ata që e mundësuan këtë Recital:

z. Lush Martini, z. Ndoc Sukaj, z. Adrian Kaçaj, Lin Kumbulla emigrant në New York, Bujtina “Adora” Tropoje dhe Hotel “FLOGA” Shkodër me pronar z. Lulash Gjeloşi.

Një Recital kërkon shumë punë, pas skenës, në këtë rast për çdo gjë u kujdes z. Valdrin Vatnikaj, vëllai i këngëtarit dhe

mik i vjetër i joni.

Pas shume viteve punë pranë artit dhe artistëve, ja jap vetes të drejtën të them se :

Etja dhe tendenca për pasuri materiale e ka varfëruar shpirtin njerëzor, sa më shumë dashuri për njeri- tjetrin, sa me

shumë muzike dhe relaksim kulturorë t’i falim jetës tonë aq më të lumtur do të jetojmë secili nga Ne.

Asgjë nuk është më lirë sesa të thuash Faleminderit! Suksese!

Asgjë nuk të bën më burrë sesa e vërteta, ndaj me bindje të plot dua të them

se, këngëtari Pëllumb Vatnikaj, me këtë Recital e ngjiti karrierën e Tij në nivelin e “Artistit të Muzikës Folklorike Shqiptare”. Urime miku jonë i nderuar, ançtari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe tani Nderi i Saj!

Me këtë rast, na dhe një leksion se si kërkohet Rruga drejt Suksesit.

Lulash Brigja,
Shkoder 29 maj 2022.



Deri kur do të mbesim peng e mendësive primitive dhe e së kaluarës?!

Duke lexuar thënien e shkrimtarit të madh Irlandez, Oscar Wilde, i cili theksonte: “Askush s’ është aq i pasur sa të blejë të kaluarën e tij!”. I thashë vetes, e bukur, me shumë domethënie, se jo në pak raste kanë bërë e bëjnë përpjekje të na marrin të kaluarën, madje pa asnjë shpërbllim, por shtrova pyetjen: Sa na shërben ne ky përcaktim i këtij shkrimtari, që ne ta kemi bazë për të ecur përpara?

Pata lexuar një thënie shumë interesante: “Në qoftë se e ardhmja e pemës dhe rritja e saj lart janë mbi tokë, rrënjët janë nën tokë. Kjo do të thotë se e ardhmja ushqehet nga e kaluara. Të mjerët ata që nuk kultivojnë kujtimet e së shkuarës”. Po, shumë e vërtete dhe nuk ka se si të jetë ndryshe, por a nuk e dimë ne, se pema rrënjët i ka nën tokë?! Po. Atëherë, pse e citoj këtë thënie?

E fillova këtë artikull, me këto dy citime, për të ardhur te vetja, për të ardhur te ne dhe për të thënë, se këto dy mendësi jo pak na kane penguar të shohim realitetin dhe të bëjmë përpjekje për të ecur përpara.

Nuk dua të ngarkoj askënd me përgjegjësi, por nuk mundem të rri dhe të hesht ndaj dy fenomeneve penguese të ecjes sonë përpara! Nuk ka pengesë më të madhe, e cila të ndalon në ecjen përpara se, kur të hyn vetja në qefte dhe nuk paraqitesh ashtu siç je!? Nuk ka fre më të fuqishëm që të ndalon në vend se, sa nostalgjia ndaj së kaluarës dhe në veçanti ndaj pushtuesit, siç ndodh me ne!?

Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, me nismën e Luigj Shyti, Prele Shytani, Pal Lera, Fran Kapaj, Martin Ara, Mri Kroj, Ndue Sanaj, Prele Milani e Zef Nika, u themelua me 32 anëtarë dhe me datën 13 maj 2003, me vendim nr. 666 u njoh juridikisht nga Rrethi Gjyqësor i shkalles së Parë në Tiranë. Nga ajo ditë e deri më sot, ajo ka planifikuar dhe realizuar mjaft veprimtari kulturore, historike dhe artistike, deri në nxjerrjen e nr. 224 të gazetës “Dukagjini” dhe promovimin e rreth 77 librave të shkruar nga dukagjinasi për Dukagjinin, në përgatitjen e zhvillimit të IX simpoziumeve shkencore, në përgatitjen e zhvillimit të dhjetëra veprimtarive, në pjesëmarrjen në dhjetëra veprimtari në hapësirat shqiptare, në veçanti në Kosovë e në Mal të Zi, në vendosjen përjetësisht në broncë në qytetin e Shkodrës atdhetarin Mehmet Shpendi e albanologun Martin Camj.

Sot Dukagjini është i nderuar me dekoratën e lartë “Nderi i Kombit” dhe ka disa figura të ndritura të nacionalitetit shqiptar: Nga 38 martiret të Lumnuem, 9 prej tyre janë dukagjinasi dhe të dekoruar me urdhrin më të lartë “Urdhri i Flamurit Kombëtar” Atë Bernardin Palaj ofm e Atë Luigj Palaj (fshati Palaj, krahina e Shllakut), Atë Çiprian Nikaj ofm (fshati Palaj, krahina e Shoshit), Atë Gjon Shllaku ofm (fshati Gegaj, krahinë e Shllakut), Dom Lazer Shantoja (fshati Vjerdhë, krahinë e Shllakut); Dom Dede Plani (fshati Plan, krahinë e Pultit); dom Mark Xhani (fshati Xhan, krahinë e Pultit); Atë Gasper Suma (fshati Sumë, krahinë e

Pultit) dhe laiku Gjelosh Lulashi (fshati Ndreaj, krahinë e Shoshit).

Të dekoruar me urdhrin “Nderi i Kombit” Atdhetari Mehmet Shpendi, Albanologu Martin Camaj, piktori Lin Delija, profesor Kole Prela, artistja e madhe “Artiste e Popullit” Tinka Kurti e Atë Gegë Lumaj.

Të dekoruar me urdhrin “Gjergj Kastrioti”; Artistët e Popullit Ndreka Luca e Pjeter Gjoka;

Të dekoruar me titullin “Mjeshtër i Madh” poeti i madh Frederik Rreshpja,



këngëtari Frederik Ndoci, biznesmeni Gjon Dukgilaj, futbollisti Lin Shllaku, mundësi Dede Bregu e Agostin Mhilli, basketbolisti Renato Radoja dhe boksieri Zef Gjoni;

Të nderuar me titullin “Krenaria e Qarkut Shkodër”-Gjergj Leqezja e Luigj Mila, të nderuar me titullin “Qytetar Nderi të qytetit Shkodër” albanologu Martin Camaj, profesor Kole Prela dhe aktori Pjeter Gjoka ; me titullin “Mirënjohja e qytetit Shkodër”, sportisti e përmasave evropiane Dode Tahiri, Ndue Sanaj (kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”), dhe të tjerë e të tjerë.

Pra, jo pak figura e personalitete dukagjinasi janë nderuar nga strukturat vendimmarrëse të shtetit, sepse vepra e tyre nuk është thjeshtë dukagjinase, por është vepër e gjithë kombit shqiptar .

Misioni i Shoqatës ky ishte dhe për realizimin e të cilit kemi punuar jo pak dhe që duhet të vijohet të punohet më me ngulm, më me përkushtim, më me kulturë, më me vizion drejt standardeve euroatlantike për emancipimin e plotë të bashkësisë dukagjinase së bashku me gjithë shoqërinë shkodrane e shqiptare nga gjithë anëtarësia e shoqatës dhe në mënyrë të veçante nga intelektualët dukagjinasi në bashkë-

punim me ata shkodrane.

Më poshtë po ndalem në dy fenomene, madje dhe problematikë, që jo pak po na pengojnë të ecim përpara!

Së pari, nuk ka pengesë më të madhe, se mendësinë primitive, që fatkeqësisht vijon jo pak dhe sot! E çuditshme, por e vërtetë.

Një shembull: “Kulla e ngujimit, një

ka personi dhe çka prezanton ...

Në një rast isha me një shokë te kjo kullë dhe pyes një person vendas:

-Sa vjet ka që është ndërtuar kjo kullë?

Përgjigja mjaft interesante, - ka 500 vjet, që është ndërtuar. Madje gjyshi im ka vendosur gurin e themelit...?!

Shoku me kap përkrahu dhe më thotë: -Ecim ...

Këto tregojnë jo vetëm mendësi primitive, por dhe mendësinë e hyrjes në qefte! Nuk ka nëme (name) më të rende nga shkodrani, kur thotë: “Të hyftë vetja në qefte!” Mund dhe të mos dish, por kur tjetri të thotë se kjo nuk bën, duhet ta marrësh kthesën. Por kur të ka hyrë vetja në qefte, nuk pranon askënd me të thënë gjë, se mend tua të duken më të mirat, pavarësisht se kujt i shërbejnë ...

... Në Breg të Lumit, është ngritur një memorial kushtuar Shtatë Shaljanëve dhe shumë mirë është bërë, se vepra e tyre duhet nderuar e përkujtuar. Vepra e tyre ka qenë një akt i lartë, që 7 burra nga krahina e Shalës, dhanë jetën në sarajet e Vezirit të Shkodrës, por nuk duhet mashtruar, nuk duhet të vendoset fotografia e delegacionit dukagjinasi, të cilët në vitin 1932, ishte nisur për të shkuar në Padova të Italisë, për të marre pjesë në ceremoninë e festimit të 700 vjetorit të lindjes së Shna Ndout. Duhet ditur, se në vitin 1802 apo 1806, që afërsisht ka ndodhur ngjarja, nuk ka ekzistuar fotografia në botë. Por, në vend të saj mund të merret një piktor e të bënte një gravurë. Kur nuk e dinë, është gjysma e së keqes, megjithëse duhet pyetur, se nuk është turp me pyet, më turp është kur sajoni e nëpërmjet sajimit mashtron opinionin. Por më e keqja, është, se kur të thonë, kur të tregojnë dhe nuk reagon pozitivisht, qëndron në të tendën dhe vijon e mashtron.

... Në krahinën e Shoshit, është një rajon, që është i pagëzuar me emrin *Guri i Lekes*. Ndaj këtij emri, të këtij objekti çfarë nuk thuhet deri legjenda të papranueshme, se në radhe të pare nuk kanë asnjë bazë historike. “Lekë Dukagjini ka qenë në këtë rajon dhe ka luftuar kundër osmanëve dhe për t’iu shmangur osmanëve ...”, shkruhet: “Ky ‘gur’ shkëmb mali, ndodhet në prehrin e Komlemit, karshi Mollës së Shoshit me plot histori, e cila lidhet me princin e kësaj krahine, Lekë Dukagjinin. Vendndodhja e këtij guri ka një pozicion strategjik vrojtimi në zonë, nga i cili Leka mund të kontrollonte një fushëpamje prej 300 gradë. Nga ky gurë, Leka, ka pikasur çdo lëvizje të armikut dhe kujt do që ka tentuar ti afrohet. Lekë Dukagjini ishte prijësi i fisit të Dukagjinit, i cili pasoi udhëheqjen e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut edhe për 10 vjet të tjera pas vdekjes së tij. Në vitet e tij të fundit të jetës thuhet se ishte tërhequr dhe ishte vendosur pikërisht në këtë zonë për tu mbrojtur nga përndjekja e turqve. Në këtë vend ai ishte i mbrojtur nga humnerat shkëmbore që zbresin thikë deri në Drin

dhe nga pas shpine nga mbrojtja besnike e banorëve të Dukagjinit. Jo shumë larg 'Gurit të Lekës', disa qindra metra, gjendet një shpellë me një hyrje jo shumë të madhe por që pas rreth 20 m madhohet dhe që vazhdon pikatë poshtë në drejtim të lumit. Edhe kjo shpellë ka marre emrin 'Shpella e Lekës', pasi në bazë të gojëdhënave mendohet që vet Leka kishte lënë amanet që pas vdekjes trupit i tij të hidhej në këtë shpellë, në mënyrë që të mos gjendej nga pushtuesit turq, duke pasur parasysh se çfarë ata bënë me varrin dhe eshtrat e Gjergj Kastriotit".

Gjithsesi, nuk gjendet asnjë dokument që të vërtetojë ku i kaloi vitet e fundit të jetës Lekë Dukagjini, as për kohën apo vendvarrimin e tij.

Kur kjo krahinë (Shoshi) apo kjo zonë, që sot e ka emrin Dukagjini, nuk kanë asnjë lidhje me principatën e Dukagjinit dhe aq më pak me Lekë Dukagjinit dhe figurën e tij, përveç emrit rastësor "Dukagjini", ja çfarë ka thurur populli me mendësi primitive, vetëm sajo e sajo pa pasur asnjë lidhje ... Është e bukur, se rreth vitit 1980, në fshatin Theth, kryetari i këshillit të fshatit, në atë kohë, Leke Simoni, ka ndërtua një krua dhe këtij kroit edhe sot, banoret i thonë "Kroni i Lekes" dhe ka mendësi, në bazë të kësaj mendësie primitive, pas një shekulli të thonë, se këtu ka qenë Leke Dukagjini... E çuditshme ky përcaktim, por dhe mund të ndodh kështu ...

...Një person shkruante: "Dukagjini është djepi i burrave të pushkës, trimërisë, besës dhe kanunit, është krenaria shqiptare, sepse në këto male lindi kushtetuta e pare Shqiptare që në kohën e Gjergj Kastriotit, kushtetutë apo siç quhet në gjuhën popullore "Kanuni i Leke Dukagjinit", ose "Jo pa qellim përmenda ideatorin dhe themeluesin e ligjit të pare Shqiptar, Leke Dukagjini, sepse dua ti bëj me dije lexuesve se, Dukagjini është një universitet në vetvete ...", ose "Dukagjini njihet prej shekujsh, atë e bëri më të njohur krijuesi i kushtetutës së pare, apo ligjit të asaj kohe, Leke Dukagjini, shok, mik dhe bashkëluftëtar i Gjergj Kastriotit ...", ose "... e dhjetëra të tjerë në të katër anët e bajrakëve të Dukagjinit ...".

Duhet bërë e qarte se, Lekë Dukagjini, nuk ka qenë dhe nuk është pjesë e kësaj zone, së cilës dje ishte zona me emrin Pulti i Vogël dhe sot është zona me emrin Dukagjini, ose më mirë me thënë "Dukagjini i Ri", Dukagjini i Shkodrës, dhe ky ndryshim emri është bërë në rrethana të caktuara historike, që nuk është rasti për ti analizuar ato. E kam thënë dhe e them përsëri, mendimin: "Nuk kanë detyrim historik, që banoret e kësaj zone, sot me emrin Dukagjini, të mbrojnë principatën e dinastisë së Dukagjinëve, dhe as banoret e krahinës me emrin Pulti dhe sot Njësia Administrative Pulti, të mbrojnë principatën e dinastisë së Spanëve apo Pulatini. Te dyja ato janë pjesë e historisë së nacionalitetit shqiptar dhe i përkasin të një periudhe të caktuar historike, për të cilën nuk kemi as dobësi dhe as merita të veçanta. Të paret e të dy palëve kanë qenë pjesë e Pultit të Poshtëm, apo Pultit të Vogël dhe ishin pultinas, përpara se të krijoheshin Principatat.

Mendoj se duhet thënë hapur dhe pa ndrojtje, dhe duhet të jetë e qartë njëherë e mirë: Në këto male nuk lindi "Kushtetuta e parë shqiptare! Themeluesi dhe ideatori i pare i kësaj "kushtetute" nuk ka qenë Lekë Dukagjini dhe asnjë tjetër!"

Miq të mi, e para, të mos bëjmë përpjekje për të përvetësuar atë që nuk është e jona dhe e dyta, të mos marrim përsipër të mbrojmë një çështje, për të cilën nuk është duke na sulmuar kush.

1- Ne po kthehemi në një "forcë të armatosur" pa pasur armik! Pra, po konsumojmë shumë "forca", duke luftuar me "mullinj të erës" se, "armiku" nuk është askund, përveçse në veten tonë, në mendjen tonë. Të gjithë ata, që e quajnë veten intelektual, duhet ta dinë se, e drejta tradicionale, kjo "kushtetute" nuk lindi me lindjen e Lekë Dukagjinit. Madje, mendja shkon deri atje që shkruhet: "Lekë Dukagjini, babai i së drejtës tradicionale ...", në librin "Dukagjini ynë" i I-r, në faqe 23.

Ajo, E drejta Tradicionale lindi me lindjen e bashkësisë njerëzore, që në themel të saj ishin katër kode: "Gjakmarja, Preja, Rrena dhe Mohimi i Zotnave". Ju lutem, ecni nëpër historinë e zhvillimit të kësaj të Drejte tradicionale, të këtyre kodeve se, do të gjeni në themelin e tyre po këto kode, por ndoshta me fjalë dhe shprehje të drejtpërdrejta apo me shprehje ndryshe. Ato ishin në Pellazgjike, në Iliri, në Kinën e largët, në Afrikën e Jugut, në Australi, në Japoni (në kohën e samurajëve), në të gjitha kontinentet. Madje iliret erdhën me këto të drejta tradicionale nga India e Veriut rreth 2000-3000 vjet para lindjes së Jezusit, në qoftë se erdhën nga ai drejtim i lindjes apo nga do të kenë ardhur.

Të drejtat tradicionale i përkasin një bashkësie pa shtet, i cili vetëqeveriset në baze të këtyre të drejtave. Në qoftë se, nacionalitet e tjera, krijuan shtetin dhe ecën mbi bazën e ligjeve, drejt progresit; ndërsa fatkeqësisht ne, ecëm dhe mbijetoam mbi bazën e së drejtës tradicionale gjatë (në rendin fisnor shumë gjatë), të cilat At' Gjeçovi për gati 15 vjet pune, me përkushtim të jashtëzakonshme i mblodhi dhe i sistemojë në një libër të veçantë dhe i vuri emrin "Kanuni i Leke Dukagjini", për të cilën ka një merite të padiskutueshme nder personalitetet e nacionalitetit shqiptar. Madje, ka të dhëna se, emrin e kësaj përmbledhje të së drejtës tradicionale, "Leke Dukagjini" e pagëzoi Faik Konica dhe ja ka miratuar At' Gjergj Fishta, në fshatin Gomsiqe, apo në famullinë Gomsiqe, në të cilën ishte famullitar At' Gjeçovi. Fatkeqësisht më e madhja qëndron në atë se, ne ende ecim mbi bazën e këtyre normave të së drejtës tradicionale dhe mundohemi me mendime e shprehje të ndryshme ti mbrojmë dhe ti justifikojmë ato, që ato nuk kanë nevojë të mbrohen, e kanë kryer misionin e tyre dhe i përkasin një historie të caktuar dhe ajo u shërben studiuesve historian, juriste, sociolog apo psikologe, por që nuk duhet të jetë pjesë e jetës së një shoqërie me shtet demokratik, shtet i të drejtës dhe që ecën drejtë emancipimit të saj, në themel të cilës është shoqëria e hapur dhe përfaqësohet nga vlerat e individit.

2- Lekë Dukagjini nuk ka qenë as shok, as mik dhe as bashkëluftëtar i Gjergj Kas-

triotit deri në vitin 1465, në betejën e Sfetigradit e në vijim! Ai ka jetuar në kohën e Gjergj Kastriotit, por sa ishte gjallë Gjergji, shpesh ishte kundër Gjergjit dhe jo radhe krijoj aleanca me turqit dhe me të tjerët për kundër Gjergjit¹⁾.

Tjetër ishte baba i Lekës, Pal Dukagjini, i cili ka qenë me të vëllanë, Nikollen në Lidhjen e Lezhës dhe mik e bashkëluftëtar i Gjergjit. Ai, Leka u vu në krye të luftëtareve të Arbërisë së asaj kohe, pas vdekjes së Gjergjit dhe në qoftë se këtë veprim do ta kishte bërë që në fillim të ardhjes në krye të rezistencës antiosmane arbërore Gjergji, Leka, ndoshta dhe e ardhmja e Arbërisë dhe e arbëroreve e epiroteve mund të ishte ndryshe. Leka ishte një mercenar në shërbim të më të fortit dhe unit të tij. Në veçanti, ai, asnjëherë nuk u bë pjesë e kësaj zone, e cila në atë kohe ishte principata e Spaneve, nuk organizojë e drejtojë asnjë betejë dhe as jetojë në këtë hapësirë, që atëherë quresh Pulti i Vogël dhe sot quhet Dukagjin, ose Dukagjini i Ri, Dukagjini i Shkodrës.

Në librin e pare "Dukagjini Ynë", në faqen 82, jepet breznia, apo gjenealogjia e një dukagjinasi, i cili e çon atë në 20 breza dhe e lidh me dinastinë e Dukagjinëve deri te Duk Gjini, Gjini Tanushi, të cilin në vitin 1281 ju dha titulli "Duke"; ndërsa në faqen 19 shkruhet vargu dhe madje edhe këndohet: *Ku Leka vatanin ka ...* Ja deri ku kërkohet të bëhet lidhja, me marre për vete ato vlera, që nuk janë të tuat, por janë e të tjerëve dhe harrojnë se, po munde të marrësh të tuat, të dalin dhe të teprojnë.

Në analizën time dhe këto janë të justifikueshme se, ishin kohë të vështira, duhej prezantuar se, je dikush dhe në këtë mënyrë duhej shpikur diçka dhe shpikëj ajo që ishte më e mundura e momentit dhe që të jepte krenari, dhe ky moment ecte sa bëhej pjesë jetës së përditshme dhe besohej. Edhe kjo është meritë, por meritë e atyre brezave, por jo i joni dhe aq më tepër duke i bërë pjesë e jona

Kjo mendësi nuk është e pakët, nuk është vetëm në këto raste, por është dhe në krijimtari, në tekstet e këngëve ...

Është një kënge për Dukagjinit, që në mes të tjerave është shkruar një varg "Dukagjini që ka nxjerrë princa...!"

Së pari, duhet ditur, se kjo zonë, që sot ka emrin Dukagjini, deri në vitin 1831 quhej Pulti i Vogël, me qendër në Dakaj të krahinës së Shalës dhe nuk ka asnjë lidhje me principatën e Dukagjinëve. Pas vitit 1831 është shkëputur nga vartësia e sanxhakut Dukagjini, me qendër në Pejë, me sundimtar Begollajt e Pejës dhe për rrjedhojë ka marre emrin Dukagjin. Unë nuk kam dokument, në të cilin mund të jetë shkruar për pagëzimin e kësaj zone, të zonës së Pultit të Vogël, me emrin Dukagjini.

Së dyti, përsëri duhet ditur, se shumica e banoreve të kësaj zone, paraardhësit e tyre nuk kanë më shumë se 15-18 breza, të cilët janë vendosur në këtë zonë dhe kryesisht në krahinën e Shalës e të Shoshit, që nuk kanë asnjë lidhje me principatën e Dukagjinëve, veçse mund të kenë ardhur prej pjesës perëndimore të Pukës (sipas studimit të z. Luigj Shyti, në librin "Dukagjini, në rrugëtim drejt gjenezës"), e cila ka qenë pjesë e Pultit

të Poshtëm dhe më vonë, me krijimin e principatave, ka qenë pjesë territoriale e principatës së Dukagjinëve. Pra, ja dhe një fakt, që tregon për mendësi primitive.

... Në një kafe, bisede me dy persona u reflektua një fenomen i tillë, që nuk e prisja, sepse te dy ishin të shkolluar. Njeri më fliste për fisin e tij, për të parët e tij... dhe po sa e mbaronte ky rrëfim i tij, menjëherë ndërhynte tjetri, për të rrëfyer për fisin e tij ...Pra, sikur ishin në një garë, se cili ishte më me zë se tjetri...Nuk e di se sa të vërteta ishin rrëfimet e tyre, se nuk më interesonin për ti ditur, ishim takua për tjetër problem, por aq më mërzi-iten, sa u thashë: *Mjaft, se vërtetë është e papranueshme biseda që bëni dhe kjo tregon nivelin tuaj të ultë intelektual.*

Mendësi primitive do të thotë, të sashojsh ngjarje e ndodhi të ndryshme, për tu prezantuar dikush para të huajve, para të tjerëve, që në çdo kohë është e papranueshme, por veçanërisht në ditët e sotme, të shekullit XXI

Së dyti, nuk ka fre më të fuqishëm që të ndalon në vend se, sa nostalgjia ndaj së kaluarës dhe në veçanti ndaj pushtuesit, siç ndodh me ne!?

Për këtë mendësi, që sjellë para nesh shprehje dhe nocioneve të papranueshme, më lejoni të nxjerr disa përfundime, që besoj jo vetëm në mirëkuptimin tuaj dhe të lexuesit të gazetës "Dukagjini", por dhe i bëjmë më mirë vetes dhe të tjerëve:

... Një miku im më vjen për vizitë në shtëpi dhe duke pi nga një gotë raki, më tregonte një bisede e zhvilluar në një ndeje darke thiu:

- Njeri prej miqve në bisedë e sipër lëvdonte nipin e tij, i cili ishte në atë darkë të thiu, aq e ngriti në "qiell" nipin, sa kur mbaroj bisedën daja për nipin, nipi ju drejtua dajës me këtë shprehje:

- *Faleminderit dajë, por je tu më lanë pa shitë ...*

Edhe ne, duke e lavdërua veten dhe ngritur deri në ato maje që nuk mbërrin kush, mbesim pa "shitë"! Ne në qiell, kur të tjerët ecin për tokë, nuk merret kush me ne, se ata nuk mund të ngjiten në qiell; ndërsa ne nuk mund të ulemi në tokë me mend, se në fakt dhe ne ecim për tokë!

Dukagjini është pjesë e shqiptarisë gjeografikisht dhe tradicionalisht. Nuk është asgjë më tepër. Në çdo krahinë të Shqipërisë, ka pasur dhe ka burra me mend, të pushkës (patriot), të besës dhe që kanë qene besnikë i së drejtës tradicionale, mbi bazën e së cilës janë udhëhequr për të mbijetuar në çdo kohë dhe ti bëjnë balle çdo rrebesi historik. Dukagjini dhe banoret e tij, dukagjinasi, me këto shprehje, me këto ide, me këto vetëkënaqësi që i japim vetes nuk bëhemi as më të mirë dhe as më tërheqës për të tjerët. Jemi ata që jemi dhe që kemi dhënë kontributin tonë modest në të gjithë ngjarjet kulmore historike të nacionalitetit shqiptar, as më pak dhe as më shumë, por si të gjithë bashkësitë, që përbejnë nacionalitetin shqiptar.

..., jo radhe në veprimtarinë e përditshme dhe sot, qoftë dhe brezi i ri, komunikojnë me fjalor të pushtuesit otoman

dhe me struktura të tij.

Sigurisht, Dukagjini dhe banoret e tij kanë vlera të padiskutueshme atdhetare, kanë derdhur gjakun, i cili së bashku me gjakun e të tjerëve shqiptare, janë çimentuar themelet e Pavarësisë dhe të Lirisë së Shqipërisë. Ka nxjerre personalitete që kanë nderuar kudo Nënëloken Shqipëri, si mësuese Kushë Micja, atdhetari Mehmet Shpendi, piktori i Rilindjes kombëtare- Ndoc Martin Camaj dhe personalitete të tjera e të tjera në çdo fushë të jetës dhe të historisë shqiptare. Por, të gjithë këto figura, të gjithë këto personalitete me vlera nacionale nuk u bënë të tillë duke jetuar me mentalitete të një shoqërie pa shtet, as me nocione dhe fjalor të pushtuesit turk. Ata, apo ato ishin larg këtyre mendësive dhe prandaj u bënë të mëdhenj në shërbim të nacionalitetit shqiptar.

Antonio Gramshi, filozof, politikan dhe shkrimtar, rreth një shekull më parë thekson: “*Ata që duan të ndërtojnë Atdheun, bëjnë mirë t’ia nisin duke ndërtuar në fillim Enciklopedi dhe Fjalorë*”. Më duket se, është e nevojshme për të pasur parasysh në punën tonë edhe ne, ketë ide të këtij personaliteti të madh Italian.

Ne, vërtetë e kemi të ndërtuar shtetin, por jo radhe dhe ndoshta në përgjithësi të jetës së tij, në themel të tij kanë qenë mendësi orientale dhe jo evropiane, kanë qenë me mendësi feudalo-fisnore të një shoqërie të prapambetur dhe jo të një shoqërie të emancipuar, të një shoqërie të hapur. Pra, me mendësinë e sundimit të fortit mbi të dobëtin, e mendësisë të atij të armatosur kundër atij të paarmatosur, të pushtetit kundër popullit, të pushtetit sundimtar dhe të popullit të sunduar në shërbim të pushtetit, të mendësi të të përjashtuarit, me mua ose kundër meje. Pra, në miq dhe në armiq. Këtë lloj mendësie të të bërit shtet, jo vetëm që e kemi mësuar në kohën e Zogut, e jetuam në kohën e monizmit, por po e jetojmë dhe në kohën e sotme. Madje këtyre dy mendësive orientale, i bashkohet dhe mendësia AI, që do të thotë: *Ai e ka fajin* dhe duke ju drejtuar të tjerëve për problemet e tua që nuk shkojnë mirë, ne asnjëherë nuk kemi ditur dhe nuk do të dimë se kush jemi dhe për rrjedhojë nuk do të dimë se çfarë kërkojmë.

Pas një shekulli, një pjesë e mirë e shoqërisë sonë dhe në veçanti të bashkësisë sonë, të bashkësisë dukagjinase, flasin: në se gjakmarrje është kanunore apo jo, apo shteti i dobët prandaj ngrënë krye normat kanunore, e të tjera e të tjera. Pas një shekulli, ose pas katër-pesë brezave të largimit të tij nga territoret shqiptare, ende komunikojmë me struktura të pushtuesit 4. 5 shekullor otoman, osman apo turk.

Ende, te ne deri dhe shkrimtarë, politikane, njerëz publik jetojnë me nostalgjinë e bajraktarit, i cili pak ka urdhëruar e drejtuar për rreth 4 shekuj rresht, prapë se prapë e ka mendjen tek ajo strukturë! Kështu, jo radhe thuhet: *Po vjen bajraktari ... Si je bajraktar ... Unë jam bajraktari i ... Në kuvendin e partisë kemi pas njerëz me autoritet, si bajraktarin ... Kështu ka thënë bajraktari i ...*

Në muajin korrik 2005, Preç Zogaj, në një shkrim, në gazetën shekulli, thekson: “... shkuam në fshatin turistik të Thethit, në Dukagjin për të mbështetur kandidatin për deputet dhe në atë takim erdhi

bajraktari i Shalës dhe i Shoshit, të cilët na dhanë fjalën, se do t’u japim votën ...”, dhe nuk thotë: “... erdhi kryetari i komunës ...”. Kur ky shkrimtar, politikan dhe një publicist i njohur, jo vetëm që është një i nënshtruar këmbëkryq politikës që përfaqëson në mënyrë qorre, por na thëret dhe na respekton me vetëdije strukturat e pushtuesit turk, pse ta paragjykojmë atë, fshatarin e thjeshtë?! Nuk dua të analizoj këto mendësi të këtij politikani, por dua të ndalem dhe në fakte të tjera, që tregojnë po të njëjtën mendësi!

Lexoja librin “*Malësia dhe Fiset e saj*”, autori i të cilit përveç punës kolosale që ka bërë në hulumtimin, studimin dhe renditjen e fakteve historike të kësaj zone Shqiptare në shekuj, jo vetëm si nocion gjeografik, por mbi të gjitha për patriotizmin në mbrojtje të nacionalitetit dhe të lirisë, që nuk mund të kuptohet historia Shqipërisë pa historinë e kësaj zone, në mbi 216 raste shkruhet *bajraku, ose bajraktari i këtij fshati apo e kësaj krahine*, në vend të shkruhet me emërimet e bukura, si fshat, krahinë, luginë, zonë apo të tjera. Ishte dhe është krejt e panevojshme të përdoren fjalë, nocione dhe institucione apo struktura të pushtuesit turk dhe të çdo pushtuesi në vend të fjalëve, nocioneve dhe institucioneve apo strukturave shqipe. Jo në pak raste ky autor shkruan: “... çmallem e për mallem me malësorët e këtyre bajraqeve shpirtnisht ...”, apo “... aty për aty të fakteve të gjalla të këtyne bajraqeve ...”, apo “*Ec nëpër katunde të bajraqeve të Malësisë së Madhe ...*”, apo “... *Të kisha e këtij bajraku ...*”, apo “... *persona nëpër ngjarje historike, bajraktarë, vojvode ...*”, apo “... *shumë emna të bajraqeve tona e marrin emnin nga i pari i fisit ose bajrakut me emen të sotëm ...*”, çka nuk është plotësisht e vërtetë, e të tjera e të tjera fjalë dhe shprehje, nocione dhe struktura të pushtuesit shekullor, që përdoren krejt në mënyrë të panevojshme dhe në veçanti nga një profesor, nuk e quaj fare normale.

... Një person ligjëronte: “... Në shekuj të shekujve nuk njohu mbi krye kurrkënd tjetër përveç Zotit dhe këto male, që i bekoj këto vise me burra zemërgjerë e trima që ndër mote u sakrifkuan për trojet e tyre, me martirë të fesë, që e flajuan jetën për Krishtin e Ringjallur; me nëna të përvujta dhe fisnike, me intelektual dhe akademikë të rangut të lartë shpirtëror; shkencor dhe filozofik, me pamjet plot madhni të bjeshkëve vigane, e të luginave të blerta, të thurura me vrashtësi shkëmbinjësh e malesh të thepisuna...”. Ose një tjetër person ligjëronte... “*Historikisht ky fis i lashtë verior, qëndroi kështjellë e pamposhtur përballë stuhive dhe rrebesheve të motmoteve të ndryshme të historisë. Këto troje ende sot e kësaj dite janë bastion i lirisë së fisit arbëror, simbol i mikpritjes tipike shqiptare, i besës së shenjtë dhe i bujarisë, e falë këtyre virtyteve të trashëguara brez mbas brezit e djalë mbas djalit, këto vise e ky popull do të jenë krenar para historisë sonë kombëtare derisa dielli i parë i nadjes të puthin ëmbël e për mallshëm krijimin. Ky shesh i bekuar, pranë Urës së Shalës, shërbeu si logu i kuvendit të burrave të urtë kapuçbardhë të maleve tona, të cilët*

i vetëqeverisën këto vise për shekuj me radhë sipas ligjeve të fesë së krishterë dhe normave zakonore të Kanunit, kushtetuta më vjetër në Ballkan ...”.

A duhet të kujtohet e kaluara? Po, duhet kujtuar e kaluara, por jo si vlerë absolute, sepse duke menduar me këto mendësi, si: *Historikisht ky fis i lashtë verior, qëndroi kështjellë e pamposhtur përballë stuhive dhe rrebesheve të motmoteve të ndryshme të historisë ...* Por kur mendon kështu, domethënë, se nuk e kemi fare të qartë historinë e vendit tonë. Mirë, more zotëri, pasi ky fis i lashtë verior, qëndron kështjellë e pamposhtur përballë stuhive e rrebesheve ..., pse u largova nga ky fis, nga ky vend dhe nuk qëndrova së bashku me ta në ato rrebeshe, të punoje dhe të arrije vlerat e jetesës normale????!! Këta a e dinë, se 3/4 e banorëve të këtij fisi është larguar nga ajo “kështjellë e pamposhtur”, për të jetuar më mirë, se në atë “kështjellë” nuk mund të jetohej?! Pra, është e lehtë të flasësh me këto mendësi, kur nuk kemi përgjegjësi para një bashkësie me mendësi primitive, pjesë e së cilës jemi dhe vete ...

A e dimë, se ky vend është braktisur nga pjesa dërmuese e të shkolluarve?! Edhe shumica e mësuesve dukagjinasi janë largua nga ai vend, sepse nuk janë kushtet për të jetuar si duhet! Dhe këta me të madhe bërtasin deri në histerizëm: Çka bën shteti?! Shteti nuk është një strukturë abstrakte, përbëhet prej njerëzve, që kanë ndërgjegje, por sigurisht varet se, çfarë ndërgjegje kanë. Pra, fajin e kësaj gjendje në zonën e Dukagjinit, në krahinat e Dukagjinit, në radhe të parë duhet ta kërkojmë te vetja

Në një shkrim, në mes të tjerave shkruhet: “*Nga lartësi ku ndodhet çdo kalimtar sheflumin e Shalës që zbret nga Thethi duke përshkruar mes për mes bajrakun e Shalës ...*”, në vend që të përdoret shprehja e bukur shqipe: “... *mes për mes luginës së Shalës, ose mes për mes krahinës së Shalës, ose mes për mes fshatrave të krahinës së Shalës, ose mes për mes Njësisë Administratave të Shalës ...*”, Pra, ishin të gjitha mundësitë të shprehjes qëllimi apo ideja me çdo fjalë dhe shprehje tjetër pa përdorur nocione turke ...

Jo radhe, njerëz të ndryshëm, por e veçanta qëndron në atë se, jo pak të rij e të reja përdorin këtë nocion dhe ketë fjalor, si: “*hoxhgjelden*”, në vend të shprehjes: “*Mirë se erdhe, mirë se të ka pru Zoti*”; “*bujurm*”, në vend të fjalës: “*urdhno, mer*”; “*bajagi*”; në vend të fjalës “*jo pak*”; “*bile*”, në vend të fjalës: “*mandej*”; “*sofër*”, në vend të fjalës “*tryeze, tervesë*”; “*pak, ose shumë kallabrek, kishte kallabrek*”, në vend të fjalës “*pak, ose shumë pjesëmarrës*”; “*milet*”, në vend të fjalës “*pjesëmarrës*” e të tjera e të tjera fjalë e shprehje të pafund.

Nuk jam gjuhëtar dhe e kam të vështirë të bëj zbrëthimet përkatëse, por po shkruaj për ato fjalë e shprehje që të vrasin veshin më shumë dhe përdoren në biseda të përditshme.

Këto mendësi, po të thuash i gjënë dhe në tekstet e këngëve. Shumica e këngëve, janë me tekst duke u kënduar “trimave”, bajraktarëve, na ishte njëherë e të tjera e

të tjera ... Ja disa tituj të këngëve: “Tre bajrakët e Pultit të Vjetër” (ai që ka bërë tekstin e kësaj kënge dhe ata që e kanë pranuar, nuk e njohin historinë dhe i bëjnë dëme historisë), “Bajraku i Shoshit”, “Këngë për Mehmet Shpendin” (ai që ka bërë tekstin e kësaj kënge e ka deformuar jetën e Mehmet (Sokol) Shpendit), “9 Bajrakët e Dukagjinit” (Ai që ka bërë tekstin a e dinë se kemi gati pesë breza, që jemi larguar nga pushtuesi osman e struktura e tij drejtuese, dhe kjo zonë, e cila e ka emrin Dukagjini, ka pese krahina dhe 40 fshatra?), “Maloku”, që në një varg theksohet: “*Jam malok, por der’ Bajrakut*”, por që duhet: “*Jam malok, por der’ të kreut, ose der’ katundit apo der’ krahinës*” dhe të tjera e të tjera.

Në një koncert recital, që u kënduan rreth 20 këngë qoftë nga këngëtarit dhe të ftuarit, të gjitha tekstet ishin me “LAV-DI...” dhe nuk pati një këngë me tekst që i këndohet të tashmes apo së ardhmes, apo një këngë të “butë”, por vetëm me “pushke”. Jo normalë!

Pra, gjendja në zonën e Dukagjinit, në krahinat e Dukagjinit, nuk ndryshon me thirrje, por me punë! Në radhe të parë, me punën e atyre që paguhen nga taksat tona, nga administrata e Njësisë Administrative, të cilët të mos rrinë duke u qarë, por të shkojnë pranë strukturave shtetërore dhe të mos dalin prej tyre pa zgjidhur problemin, të punojnë aq me përgjegjësi deri sa të çojnë në këmbë bashkësinë e tij dhe të ulen këmbëkryq pranë godinës së strukturës shtetërore, duke mos llogaritur se cila forcë politike është në pushtet...Pra, ne duhet të ngrijmë veten, duke u largohemi nga këto mendësi, që po na largojnë çdo ditë e më shumë nga njeri-tjetri, nuk po na lejojnë të emancipohemi, ta duam njeri -tjetrin siç jemi, të ulemi e të kuvendojmë së bashku, të shkëmbejmë mendimet për të ardhmen dhe të përcaktojmë se çfarë duhet bërë, që ne të ecim dhe të ecim. As kush nuk do të na marri për dore, në qoftë se nuk do të ecim vetë, edhe mund të rrëzohemi, por përsëri të ngrihem e të mësojmë të ecim pa u ndalur, deri sa të arrijmë atje ku duhet, megjithëse dhe atëherë duhet ecur, për të arritur objektiva të tjera e të tjera. Por dhe njëherë e përsërisë, se nuk ecet pa ngulitur në krye mirë e mirë, se sot është koha e shoqërisë së hapur, në themelin e së cilës janë vlerat e individit.

Këto mendime i shtroj para lexuesit të gazetës “Dukagjini”, me qëllimin e mirë se, duhet të ecim përpara me kërkesat kohës, me kërkesat e emancipimit të shoqërisë dhe të hapjes së saj drejt standardet euroatlantike, dhe jo të mbesim peng e mendësive të së kaluarës, të një shoqërie primitive, të një shoqërie të kushtëzuar nga pushtuesi shekullor, i cili për rreth katër shekuj, me dekret të veçantë nuk na la të lexonim e të shkruanim shqip, të cilat jo radhe na kanë kushuar shumë shtrenjtë.

Të gjithë ata, që kanë mendime ndryshe, janë të mirëpritur dhe të mirëkuptuar!

1) Oliver Jeus Schmitt “Skënderbeu”, viti 2008, fq. 176, 201, 203, 205, 207 e 417

Prof. as. dr. KOLË TAHIRI - bartës i vlerave qytetare e kontributit të shquar pedagogjik

Qysh në fillim dua të pohoj se me Profesoren jemi nga i njëjti fshat, lagjet tona komshi e vëllezër (Pjeternikaj e Vuknikaj); kemi pasur historikisht e kemi lidhje të mira familjare, kemi ndarë gëzimet e hidhërimet, duke ndihmuar e përkrahur njëri-tjetrin në përballet e vështirësive që krijon jeta. Ndonëse unë jam më i vogël më se një dekadë e Ai është larguar nga fshati qysh 10 vjeç, unë e njoh mirë jetën e peripecitë që ka kaluar, sepse vazhdimisht ka mbajtur lidhjet me vendlindjen, ka ardhur rregullisht me pushime, kur ishte nxënës e student, kur punonte në Tiranë apo qytete të tjera, madje edhe kur është larguar për jashtë vendit e ka banuar në Belgjikë. Në vitet kur e transferuan në Tropojë e punoi drejtor i Kabinetit Pedagogjik, unë pata një lidhje të ngushtë pune, se isha drejtor i Shkollës së Mesme të Bashkuar, Lekbibaj

Ai u lind me 12 maj 1936, në fshatin Shëngjergj të krahinës Nikaj-Mërtur.

Vitet e para të fëmijërisë i ka kaluar në fshatin e lindjes, midis sëmundejeve, rreziqeve, tragjediave familjare e varfërisë, por edhe përkujdesjeve e dashurisë prindërore.

Në moshën 1-vjecare, kur doli nga koma në Kishën e Nikajve, kur pjesëmarrësit e kishin llogaritur të vdekur, nëna e tij e pajisur me të gjitha virtytet pozitive, çdo natë të Shënkollit të Pranverës, ndizte një litër dylli. Me ritet fetare dhe lutjet e përditshme, është rritur në atë mjedis familjar e shoqëror dhe, padyshim, i ndikuar edhe nga fryma fetare, me një far neutraliteti dhe respekti ndaj saj, si çështje private e njeriut.

Kanë ushtruar ndikim gjurmëlënës në formimin e personalitetit edhe atmosfera e rënduar e Luftës së Dytë Botërore, fluturimi i avionëve luftarak mbi qiellin e krahinës, zhvillimi afro dhjetëditor i luftimeve frontale në qafën e Kolçit, midis forcave nacionaliste e brigadave partizane, “zhdukja” pa gjurmë e babait për disa ditë, disa vrasje, burgime e internime në Tepelenë nga rrethi familjar, të cilat i kujton me dhimbje, por edhe pasojat e privacionet që rrodhën në vitet e mëvonshme.

Familja e tij, e shquar për traditat më të mira, ka gëzuar e gëzon respekt të veçantë në krahinë e më gjerë; i kam njohur e i njoh nga afër, ndaj shprehem pa xhelozë.

Po më vjen në ndihmë edhe një emal dërguar Profesorit në Bruksel me 22 prill 2018: “Ndjej kënaqësi kur komunikoj me ju, familja juaj në një kuptim më të gjerë ka qenë fisnike në zemër, në ndershmëri, sinqeritet, në bujari, thjeshtësi e zemërbardhësi, me ia dashtë të mirën tjetrit, pa xhelozë”. Kjo familje, sidomos i ati, Tahiri, ka pasur një veçanti të pazakontë jo vetëm në krahinë, po edhe në Veri: kanë zotëruar e kanë ditur ta përdorin pozitivisht me mjeshtri humorin, çka tregon

nivel e një dhunti intelektuale. Diku nga vitet '80 pata thënë për Tahirin se ka kontribuar në argëtimin e njerëzve më shumë se një shtëpi kulture, çka mund të më merrej edhe e keqkuptuar për kohën.

Rrugëtimi i Kolës ka qenë i gjatë, plot ngjarje e peripeci, më shumë të përpjeta se sa të tatëpjeta, shumë më shumë suksese se sa dështime, shumë i vlerësuar, por edhe i anatemuar nga persona jo me shumicë, për arsye konkurrence e xhelozie në punë, duke e goditur për disa

osin e Kreshnikëve e shumë këngë nga “Lahuta e Malësisë”, të cilat i kanë lënë gjurmë në formimin shpirtëror e mendor.

Në vitin 1956 ka marrë maturën e Shkollës së Mesme Pedagogjike “Shejnaze Juka” në Shkodër, me rezultate të shkëlqyera, duke kryer edhe detyra shoqërore, si atë të z/sekretarit të komitetit rinise për shkollën, detyrë që e ushtroi në të njëjtin pozicion kur ishte pedagog në Institutin Pedagogjik në

me ekipet e qytetit të Shkodrës, veçanërisht në atletikë e futboll, por edhe më vonë kur e transferuan me detyrë shtetërore në qytetin lindor të Peshkopisë, ndonëse me ngarkesë mësimore të plotë në shkollë të mesme.

Në formimin tij shkencor-pedagogjik, kulturor e arsimor dhe në formimin e personalitetit kanë lënë gjurmë të thella, sidomos Leningradi (Saint-Petersburgu) me historinë, rrethimin e famshëm të Leningradit në Luftën e Dytë Botërore, me kulturën, shkencën, artet, njerëzit dhe studentët e ardhur nga Evropa e Azia. Padyshim edhe Moskë ka qenë mbresëlënëse. Përshtypje të paharruara i pati lënë edhe Festivali Botëror i Rinisë i vitit 1957, i zhvilluar në këtë kryeqytet.

Gjatë viteve të studimeve, pati shënuar inicimet e para në punën studimore mbi baza metodike shkencore. Në vitin 1957, në sesionin shkencor organizuar në Shkollën e Lartë të Bashkimeve Profesionale të Leningradit, ka mbajtur kumtesën “Për harmoninë e bashkëjetesës ndër fetare në RPSSH” (bashkautor), e cila ngjalli interes e diskutime, sepse përbente risi për studiuesit vendas.

Në vitin 1959, në Konferencën Shkencore të Universitetit “Patjemkin” në Moskë, ka referuar kumtesën: “Për revolucionin kulturor në RPSSH”, mbajtur edhe në sesionin shkencor të fakultetit. Po këtë vit, i është botuar në gazetën “Pionirskaja pravda” (Gazeta pionieri sovjetik), një shkrim për organizatën e pionierëve në Shqipëri.

“Në jetën time bashkudhëtarë të pandarë kam pasur punën fizike bujqësore në fshat, lojën e futbollit dhe punën intelektuale: librin, studimin dhe të shkruarit me dorë e në kompjuter” -pohon Kola.

Qysh në vitin 1960 kur filloi karrierën pedagogjike nuk i është ndarë punës studimore-shkencore, e cila ka njohur vetëm rritje cilësore e sasiore: Në fillim në Shkollën e Mesme Pedagogjike “Shejnaze Juka” në Shkodër, pastaj në qytetin e Peshkopisë, pedagog në Institutin Pedagogjik në Shkodër, në Drejtorinë e Studimeve e Botimeve Shkollërore, me detyrën e inspektorit metodist pranë Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës (vitet 1965-70) e 6 vite në Tropojë si drejtor i Kabinetit Pedagogjik pranë Seksionit të Arsimit e të tjera. Kudo punoi, puna e tij qe e përkushtuar. Në Tropojë u bë promotor e misionarë për rritjen e nivelit psiko-pedagogjik e shkencor të mësuesve, për përvetësimin e metodave të reja të mësimdhënies e mësim nxënies, në hapjen e disa shkollave fillore, çka ndikuan dukshëm në forcimin sasior e cilësor të shkollës.

Siç më ka shpjeguar, “Për mua dhe familjen time, një provë e vështirë qe edhe qarkullimi familjar nga Tirana në Tropojë. Qëndrimi së bashku me familjen prej gjashtë vitesh në qytetin e Bajram



lidhje familjare me njolla në biografi.

Ne vitin 1946, në moshën 10 vjeçare, është pranuar në konviktin “Tomë Kola”, në Shkodër. Falë sedrës, këmbënguljes e intelektit të veçantë, ka mbaruar dy herë nga dy klasë për një vit: klasat II-të e të III-të fillore dhe të V-tën e të VI-tën.

Gjatë gjithë jetës u është përmbajtur porosive e edukatës familjare për ruajtjen e besimit të Zotit, sjelljen morale pozitive (kundër vjedhjes, gënjeshtërisë, spiunimit, grindjeve me shokë, e të tjera). Ky kod moral-fetar, i ka shërbyer si udhërrëfyes i sjelljes e qëndrimeve në shkollë e në shoqëri.

Në vitet e rinisë së hershme, në shtëpi e në bjeshkë me bagëti, pati lexuar e mësuar për mëndësh, pa asnjë detyrim, një pjesë të mire nga folklori i krahinës, Ep-

Shkodër, ndonëse i paorganizuar në Parti. Po në këtë vit i jepet e drejta për studime të larta në ish Bashkimin Sovjetik, në fillim në Leningrad (Saint-Petersburg) e më vonë në Moskë. Përveç dashurisë për dijen, një ndër pasionet e tij ka qenë edhe sporti.

Aty ka krye njëkohësisht fakultetin “Pedagogji-Psikologji”, por edhe fakultetin për “Edukim fizik”. Ai shprehet me emocion: “Me kujtohet, se pata dhënë normat përkatëse edhe për ecjen me patina në akull e marshimin me ski. Mbi këtë baze pata fituar titullin “Mësues i edukimit fizik për shkollën e mesme”. Ruan diplomën me përfundimin “Shkëlqyeshëm”.

Gjatë viteve të shkollës së mesme ka qenë aktivizuar dhe stërvitej rregullisht

Currit pati qenë një provë jo e lehtë. Kujtoj këtu, se dy vite kam qëndruar larg familjes duke e rënduar bashkëshorten Ola, e cila, krahas detyrës shtetërore, kujdesej edhe për fëmijët. Është merite e saj që përballoi me sukses këto dy detyra me shumë përgjegjësi. Ndjehem mirë dhe i plotësuar që pata arritur të kryeja, për një kohë relativisht të gjatë detyrën prindërore ndaj katër fëmijëve të motrës sime Lula, bashkëshorte e Perlë Nikës - Bukovë, të cilët, për shkak të aksidenteve natyrore, goditja e rrufesë në oborrin e shtëpisë dhe vdekja natyrale e Prelës në spitalin e Tiranës, bënë që ata të mbeteshin jetimë. Në ato kushte, pata marrë përsipër, së bashku me Ollgën, kujdesin për jetën e tyre, sistemimin, rregullimin në institucione shtetërore e deri në krijimin e familjeve të veta të lumtura. Atyre nuk u ka munguar as kujdesi i dajës Sokol e të tjera.”

Ata, sot banojnë larg njëri-tjetrit: në Tiranë, Lajpcig të Gjermanisë dhe në Londër. Gjendja dhe përparimi i tyre përbëjnë krenari e sukses. Në ditët tona, ata (Martini në Tiranë, Loreta në Gjermani, Marku dhe Vuksani në Londër) gjatë tërë tranzicionit të vështirë shqiptar e kanë treguar veten qytetar të denjë. Ata kurdohet kanë qenë dhe mbeten mirënjohës jo vetëm ndaj organeve e organizmave shtetërorë në Shqipëri, por edhe ndaj atyre personave që i ndihmuar e përkrahen në përballet e vështira të jetës.

Qytetaria, thjeshtësia, komunikimi i ngrohtë me kolegët, humanizmi e lidhjet shpirtërore me vendlindjen e farefisit, me të gjitha shtresat, me të skamurit e ata në nevojë, kanë qenë ndër vlerat e përhershme, pa shfaqë asnjë lloj mendjemadhësie a përbuzje, madje dilte hapur edhe shëtitje në qytet, pa i mohuar as ata, as prejardhjen e tij nga fshati për të cilin fliste e flet me krenari.

Me 6 prill të këtij viti, pas një shkëputje disa javore, u lidha me të në Bruksel e biseduam gjatë. Me shëndet mendor e fizik dukej shumë mirë për moshën që ka, me mallin e nostalgjinë e pashuar për vendlindjen, për fshatin ku u lind e u rrit, për Tiranën ku banoi e punoi për shumë vite, për shumë shokë e miq në shumë qytete e fshatra, me të cilët kontribuuan suksesshëm një jetë të tërë. Rrjedhjet e ngjarjet janë të vrullshme, por emri e kontributi i tij do të kujtohen gjatë.

Në emalin tim kam shkruar me 6 mars.2020: “I nderuar Kolë! Gëzuar edhe për shumë vite Festën e 7 Marsit! Mirënjohje për kontributin tuaj të çmuar mbi gjysmëshekullor për zhvillimin e forcimin e arsimit, për punën tuaj të vyer në fushën e shkencës e kulturës, për vlerat tuaja të spikatura morale e intelektuale. Suksese të mëtejshme, shëndet e jetë të gjatë!”

Kudo ku mësoi e punoi, në çdo moshë e deri në ditët e sotme, ka dhënë e manifestuar vlera, ka shërbyer e mbetet model frymëzimi me shembullin e tij pozitiv.

Për formimin e moshës e shkollës mesme, një ish bashkë maturan, mbas 50 vitesh ndarje, Fritz Radovani, shkrimtar e publicist i mirënjohur, me banim në Melburn (Australi), sjell kujtime edhe

për konviktoret e asaj kohe:

“Kole, jo më pak krenar, jam me Ju, që në kushte tjera kurrën e kurrës nuk e keni mendue një të keqe ndaj ne të “deklasuarve”. Nuk asht pak, MIK! ... mbasi brenda qelizave të trashëgimisë Tande, fatbardhësisht, duhet thane, se ke mujt me zgjue nga gjumi gjysmë shekullor, ato, që të tregojnë njeri. Ne ia mbërritëm kësaj dite. Fatmirësisht, edhe të panjolllosun”.

Kur kam kuptue, se nuk jam gabue tue mendue gjithmonë mire për formimin Tand, dhe se, as nuk kisha ndigjue gjithë këta vite, se ke ba një të keqe, atëherë kam kërkuë...lidhje me ty.

Me njerëzit që i njoha atëherë, vazhdova Miqësinë, pa asnjë ndërprerje...dhe i kam miq edhe sot. ... mbasi ishin kohë të vështira kur ne ishim miq, po ishte edhe kohë prove, aq sa njohje edhe për të ardhmen. Nder Ta, me shume dashni e respekt mund të rreshtoj edhe Kolë Tahirin.” Përfaqime! Fritzi, Melburn, 2015.)

Ai ka udhëhequr eksperimentin shkencor “Për mundësinë e zbritjes moshës e pranimit të fëmijëve në shkollë nga 7 në 6 vjeç”, mbi bazën e të cilit, në vitin 1972 është aprovuar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPSH ligji përkatës. Në atë eksperimentim u patën përfshirë shkolla (klasa) të ndryshme në Tiranë, Lezhë, Mat, Korçë e Shkodër, në qytet e fshat.

Veprimtaria pedagogjike, studimore-shkencore e botuese.

I. Teknolog-autor i librave universitare e shkollore.

1. Psikologjia për shkollat pedagogjike. Tirane, 1971, 1975, 1986, 1996. (Bashkautor).

2. Psikologjia parashkollore. Tirane, 1972, 1974, 1985.(bashkautor e bashkë redaktor).

3. Psikologjia për shkollat minoritare greke. Tiranë, 1985. (Adaptim e përkthim në gjuhën greqisht).

4. Psikologjia e personalitetit për shkollat e larta. Tirane 1984, 1985, 1986, 1989. (Bashkautor dhe bashkë redaktor).

5. Psikologjia për Institutin e Kulturës Fizike “Vojo Kushi”.Tiranë 1973, 1981 (Bashkautor).

6. Psikologjia Moshore. Tirane, 1989 (Bashkë autor dhe bashkë redaktor).

7-Tekst mësimor për kursin 1-vjeçar pasuniversitar të pedagogjisë e psikologjisë. (Botuar për herë të parë).

Nga 7 kapituj që ka teksti kam hartuar 5 prej tyre:

- Psikologjia moshore, objekti, detyrat dhe rëndësia e studimit të saj.

- Përsheptimi i zhvillimit fizik e psikik- dukuri objektive e kohës sonë.

- Veçori psikologjike të moshave: Mosha nga lindja deri në 3 vjet. Mosha parashkollore. Mosha e re shkollore. (Gjithsejtë 170 faqe, nga 238 faqe që ka teksti).

II. Libra psikologjik e pedagogjik e të tjera.

1. Për lidhjen e mësimin dhe edukimit me prodhimin shoqëror në shkollën fillore. Tiranë, 1967.

2. Parashkollorët. Karakteristika psikologjike. Tiranë, 1988.

3. Tahir Sheremeti mahitet me njerëzit e kohën. Tiranë, 2009, 382 faqe.

4. Z. Froid: Psikologjia e seksualitetit. (Përkthim). Tiranë, 2012.

5. Pranimi i fëmijëve në shkollë në moshën 6-vjecare dhe përsheptimi i zhvillimit fizik e psikik. Tiranë, 2013.

6. “...e megjithatë qëndruam.” Tiranë, 2014. (bashkautor).

7. “Gjuha shqipe në Belgjikë.” Tiranë 2016.

III. Kariera shkencore: Studime e kumtesa të botuara në libra të ndryshme.

1. Disa përfundime nga eksperimentimi me nxënës të pranuar në shkollë në moshën 6-vjecare (Seanca plenare). Konferenca e Studimeve pedagogjike. Tiranë. 1969. Botuar në librin: “Për një hop te ti cilësor ne zhvillimin e pedagogjisë m-l.” 13-15 tetor, 1969, f. 82-90.

2. Akselerimi dhe disa probleme pedagogjike. Konferenca II e Studimeve Pedagogjike. Tiranë,1982.

3. Koncepte në sferën e edukimit të fëmijëve në familje dhe përsheptimi i zhvillimit fizik e psikik. Botuar në librin : “Sesion shkencore i kulturës”. Tiranë 1973.

4. Probleme të zhvillimit mendor e moral dhe disa probleme të letërsisë për fëmijë. “Simpoziumi i letërsisë për fëmijë. Tirane 1974, f. 161-177. Në librin me të njëjtin titull.

5. Adoleshenca dhe shfaqjet e huaja. Botuar në librin: “Psikologjia e moshës 3-15 vjeçare. Tiranë 1989, f.159-204.

6. Probleme psiko-pedagogjike të moshës së rritur shkollore. (Botuar në librin: “Psikologjia e moshës së rritur shkollore.” Tiranë, 1985, f. 42-47).

7. Problemi i luftës kundër shfaqjeve të huaja në moshën e adoleshencës. Sesion shkencor kombëtar. (Botuar në librin: “Probleme psikologjike të moshës adoleshencës.” Tiranë, 1982).

8. Çështje të edukatës moralo-qytetare në shkollën 8-vjecare. Konferenca III e Studimeve Pedagogjike. Tiranë, 1975.

9. Arritje e probleme të zhvillimit të shkencave psikologjike në vendin tonë. (Botuar në librin: “100 vjetori i Mësonjëtores së parë shqipe në Korçë”.Tiranë, 1989, fq.277-282).

10. Beqir Ndou- Një jetë kushtuar idealeve atdhetare.(Botuar në librin. M.Palnikaj. “Beqir Ndou.” Tirane, 2011, fq. 354-362).

11. Dyzet vjet shkollë shqipe në Belgjikë. (Botuar në librin: Shkolla për gjuhën dhe kulturën e atdheut dhe identitetit kombëtar). Prishtinë, mars 2007, fq. 45-54).

12. “Thërrime nga “sofra” shkencore e një akademiku.” (Botuar në librin : “Bedri Dedja në kujtesën tonë...” Tiranë, 2010, f. 164-176).

13. “Vështrim etno-psikologjik i një karakteri shqiptar”. (Botuar në librin: “Myrteza Bajraktari. “Një vështrim tjetër i historisë. Shënime historike. Tirane 2011, fq. 254-260).

14. Në nderim të prof. Shefik Osmanit. Nga ndihmesa e tij për mësimin plotësues të gjuhës shqipe në diasporë. (Botuar në librin: “Vlerësime për prof. dr. Shefik Osmanin. Tiranë, 2014, fq.

306-310).

15. Qëndrimi ndaj pronës shoqërore, tipar i rëndësishëm i ndërgjegjes socialiste. (Botuar në librin: “ Buletini shkencor i Institutit Pedagogjik Shkodër”. 1966, fq. 369-383 dhe në

në librat: “Shkolla fillore.” Tiranë, 1966, 1968, 1969, 1976, 1986), por edhe shkrime në tekste të tjera shkollore apo buletine.

16. Ka hedhur kujtime në libra për : - Akademiku B. Dedja, “Mësuesja e Popullit”, Fatbardha Gega, Prof. Shefik Osmanin- përkushtuar i arsimit dhe shkollës shqipe, Atdhetari Myrteza Bajraktari-tërë jetën për çështjen e madhe kombëtare, Beqir Ndou - propagandues i Lëvizjes Komuniste në Malësinë e Gjakovës dhe Kosovë.

IV. Ka qenë i pranishëm në revista shkencore e shtypin tonë që nga viti 1962 e në vazhdim, çka do të thotë afro tre çerekë shekulli.

A. -Revista shkencore: Gjatë viteve të karrierës dhe pas daljes në pension ka botuar artikuj kumtues e studime, në më se 10 tituj organesh shtypi, brenda dhe jashtë si : “Arsimi popullor”, “Revista Pedagogjike”, “Historia e arsimit dhe shkollës”, “Shqiptarja e re”, “Për mbrojtjen e atdheut”, “Kultura Islame”, “Perla”, “Kuç e Zi”, “Ylli”, “Zëri i Rinisë”, “Shkenca dhe jeta”, Buletinet shkencore të Institutit të Studimeve Pedagogjike: “Shkolla fillore”, “Shkolla 8-vjecare”, revista “Malësia” që del në Mal të Zi, “Dituria”, “Dielli Demokristian” në Vjenë etj.

B. -Gazeta kombëtare: Ka qenë kontribues në më, se 15 organe të shtypit përditshëm e periodik si : “Mësuesi”, “Zëri i Popullit”, “Bashkimi”, “Rinia”, “Pionieri”, “Republika”, “Zëri i rinisë”, “Bota sot” Zyrih- Zvicër, “Dielli”- Boston, “Nacional”, “Dukagjini”, “Nikaj -Mërturi”, - “Malësia”, e të tjera.

V. Bashkëpunim në internet: “Zemërshqiptare”, “Shqipnia Etnike”, “Fjala e lirë”, Portali i gazetës “Bota sot” etj.

Vëmendjes autorit nuk i kanë shpëtuar, as vajzat e shquara të fshatit tonë si Rexhina Tahiri- Kapllani, Bardha Mici-Bakraktari , Lena Marku -Fusha, Dalina Malaj- Papelekaj, Pashka Malaj- Neçaj, apo profesoresha e matematikë - fizikës, Ollga Panajot Suraj, bashkëshortja e autorit etj.

Në dosje presin dritën e botimi. libra si :

- “Nikmengjajt e Mërturit” me protagonist kryesor Tunxh Miftarin, bajraktari i fisit Mërturit.

- Beqir Ndue Sokoli- drejtues i Lëvizjes Komuniste në Malësinë Gjakovës e më gjerë e të tjera.

Duke e mbyllur këtë shkrim, ku përfshihet një pjesë e kontributeve e veprimtarisë së Profesorit, i cili banon në Bruksel prej afro 25 vitesh, ka një familje intelektuale e të shëndoshë, e cila ruan dashurinë, traditat e lidhjet me Shqipërinë, ndjejmë kënaqësi që gëzon shëndet të mirë, është aktiv e vazhdon të shtojë e pasurojë arritjet e deritanishme.

Frrrok Vukaj

TATA KUKEL

(Për ata që nuk duan të harrojnë vuajtjet stërgjyshore)

Tatë e thërrisnin gjithë rinia. Burrat e motit në çetë, çergë strugë, e argati i drejtoreshin: A je, si je Kukel Ndreu? Të lumtë goja, tu rritë ndera, të pleqnoftë djali e të tjera, si e lypte rendi i kuvendit. Tata Kukel kishte të gjitha okët e një kerrçi, shtatin, urtësinë, fjalën e besën. Shtatin, krrabën, tërvezën dhe lahutën i kish zanat si ai.

Sipas nevojës mbante veshe gozhupin e galmë në stuhi e murrta. Kur pjalmica të verbon borën e çante si arusha me barrën një grymëm sanë ose mkrihcën e drunit sa një lis.

Në kuvend e shëtitje mbante xhamadan cohe, me fije ari, kutinë e badenit e varë në xhepin e përparme të jelekut, pipin e qelibarit, sahat e qostek...

Kur shkante të siguronte bukën familjes ngarkonte zhaben 50 okëshe me kallamoq.

Në sup mbante kordumen, në brez qemerin me 100 fishekë dhe voziste përmes, qafave e monopateve herë në mes të vapës së korrikut, here mes borës së frorit. Sa e sa shtegtime ka ba tata prej Shkodre, Gjakovë e Gucie deri në Dukagjin. Verës me lehtësua ecjen, hiqte tirqit e jelekun dhe ecte në këmishë e tllina të bardha. Opinga me lëkurë lope, për të mos i shqye gurishtave e zhareve e i mbante në dorë tue ecë për Diell e për Hanë ngarkuar për bukën e gojës.

Familja, miku, shtegtari, donin bukë. Shpia tërveztare një bukë gjithmonë e linte në dritare, me pa kalimtarë e me bujta pa frikë në pastë nevojë me hangër. Buka ishte ndera edhe krenaria e shpisë dhe gjithë jeta rrotullohej rreth magjes së bukës.

Kush siguronte bukën vet kish të gjitha mirësitë. "Bukën malësori e nxirret me thonj prej shkëmbit. Pasha bukën!" ishte nga betimet ma të shtrenjta. Në Brigje ma e mira shpi nuk kish ma shumë se 8-7 argatë. Arat në vërrin ishin ku me pak e ku pa ujë sa i zhuriste edhe Hana. Rrahjet në bjeshkë mardheshin prej bryme, shumica e tymeve nuk banin as 6 muaj buke....

Ishte kohë pranvere mes Pashkëve e Shëngjergjit, atëherë kur kotecat ishin

herrë.

Veç farën e arës varun në tra, e një bukë miell në magje la në konak Kukeli, kur u nis për në qytet të Gjakovës.

Gruaja i tha

-Prit more njeri sa te gatuaj njatë bukë, që na ka mbete e merre një copë me veti se, ke me ba gjashtë ditë e net rrugë.

-Grua e me jep zhabem e larme, unë duroj, por njata zharq kur t'i marrin uja thonë; duam bukë! Ata janë vocërrakë e nuk dinë gja se drithi asht në Gjakovë e mullinj në Gjocaj.

Tata mori zhabën dhe balqin e barrës dhe u nis tue kalue qafat me radhe pa vu kurrnga në gojë përveç ujët e duhanit. Kur ra në treg të Gjakovës e ngarkoj deng zhaben me kallamboq, që e bleu sa i biri tamen. Mbas bleu koshiqin nuk i mbeti kryq leku në xhep dhe u nis si div i gëzuem mbasi për një muaj familja nuk do ta ndjenin mungesën e bukës. Atëherë do përsëritej çdo muaj deri sa të binte kora e re. Në Krasniqe shkoj tek një kumbarë i veti, por nuk kish pas njeri aty, me sa duket kish dal me argati në bjeshke. Thirri në një derë tjetër e doli një nuse e i tha;

- Nuk i kam trimat në shpi.

Me thanë më jep një bulshi bukë i erdhi turp. Mbas 36 orësh bukën thatë do ta shijonte ma tepër, se zotnia bakllavën. Lodhja dhe uja janë dy trame të rënda edhe për një arushë si Tata.

Tue ecë ngarkuet mes vapës zorrët filluan të zihen gav-gave njana me tjetrën.

Ç'të baj mendonte, kur kurrkund nuk të shifte syni shpi njeri as stan.

Unë nuk jam orteku! Burri, që i thotë vetit burrë e ka gjithmonë e gjithkund orën çuet.

Uli zhaben prej shpine, zgjidhi gryken mori një pale grushta kallamboq i shtypi me një guralec në një quk guri dhe aty afër burimit i futi në gojë. Kollomoqi ishte fare e bardhë "Morave" e zorshme e blue mullini. Tata shtrëngoj nofullat si me morse dhamballët me smalt të çelikle i vu në lëvizje si sharra shirit e që pret e copëton çdo nyje. Copat e kokrrave goditeshin pa mëshirshëm poshtë e lart

sikurse të gjendeshin në ulluk. Në fund të procesit thermues i shtynte me ujë në zgavrën zbrastë të stomakut. Nuk thonë kot se, njeriu asht më i forte se guri. Tata në luftën për ekzistencë arriti deri në kufijtë e legjendës. Pas kësaj përtpje të mundimshme dhambet iu mpinë goja iu gjakos, por stomakun e vuni në punë tue u blue si mullin i pa cakatur.

Pas kësaj dreke të denje për njeriun e Neandertalit mbushi çibukun me duhan dhe filloj udhën që i kishte mbete pa e "ndije ma lodhjen". Kur mbërrini në shtëpi fëmijët i dolën përpara tek shtegu i oborrit e thirrën gjithë gëzim ...

Erdhi Tata, erdhi Tata! Gruaja i mbajti zhaben e rënde mbushur rrafsh.

-A u lodhe burro?

-Jo, jo nuk "u lodha as një fije". Si kam me thanë u lodha, kur të dalin krah hapun kësi zogjsh pllummash. Hajdeni ua marrte Tata të keqen, dhe i përqafoj tue i puth plot dashuni

Djali i vogël, që sa kishte fillue me fole i thotë:

- Tate a na puneee mieel?!

- Po more bire të paste baba, kam pru kollomoq të bardhë si bora e tash po knaqeni tue hangër bukë të nxehtë, me djathë e tamel lope.

-O Tate unë due kulaç, nana më ka thanë, se kur të vinë Tata do të gatuej kulaç në kaki. Po more bire qetash po bluen baba për ty në mokën e nana po skuqë cërumen. Veç mos u mërzi e nuk po vonojmë aspak me ta ba qefin.

Pa pritë me u tha djerset, mori një shoshe drith dhe e filloj të sillte gurin e randë të moknës. Ai e dinte se nuk ka mirësi ma të madhe se me u shujtë urinë njerëzve, sidomos të vegjëleve, që nuk e dinë çka janë hallet e kësaj bote...

Guri i moknës sillej fluturimthi në mënyre centrifugale nga krahët e fuqishëm të Tatës. Për një gjysme ore blua-jti rrapsh një shoshë miell. Mbas pak u gatuan kulaçet dhe camarrllokët filluan t'i hanë me kënaqësinë të madhe. Edhe buka e kakinit nuk vonoi e doli prej çeremet me një arome joshëse. Por Tata Kukel nuk ishte në gjendje të hante, mishi i dhëmbëve i ishte ajtë e pezmatue.

-Si asht puna more njeri, që nuk po ulesh me hanger me ne?

-Nuk po due moj grue, "kam hangër" një mesdite në Krasniqe. Nuk po ja prishi asaj sille të mirë që më gatoi kumbara.



- More burrë në Krasniqe e këtu është një ditë rrugë.

-Mos je pa qef e nuk pa na dëfton.

- Jo nuk jam pa qef veç ma bier një gotë raki rrushi, nga ai rrezagiu, se kam një fare pështjellje në stomak prej lodhje e rakia ndoshta po ma largon.

Rakia i nuk vlejti për stomakun, por për të kurue mishin e dhëmbëve. Piu bulmet e iu desh të priste të pas nesërmen me hager veç tue miçlue pak tul të përsheshun në bylmet...

Tata Kukel mes dimrave të gjatë e verave rrezatave qëndroi si çetina në shkamb. Ditën shkove në pushimin e pasosur, kulla granite mbeti pa oxhak. Pushka, gozhupi e laku mbetën varun në kunj. Rrathët borës pushuan në shkorsën e tymosun. Tërveza, çua bujarin, parmenda bujkun dhe, posti plakun e urtë.... Tata Kukel nuk ishte hero madhështorë, që sfiçoj vuajtjet mizore, që mbollën e rritën të huajt nder ne. Kukeli dhe tatat e maleve si përcjellës të artë të gjakut pellazgjikolir ruajtën nder shekuj vitalitetin racës sonë të vjetër. Tata ka me vdekë vetëm kur nipat e stërnipat e tij të shpërndarë si nëpër botë të dashuruar pas qejfeve kanë me harrua vuajtjet tua mizore. Dru se kur të bjerrim kujtesën për tatat e kukelat që mbijetuan si anxa e ndryme në zgjer nga pa dija kemi me i thirr dërrit dajë!

Prele Milani

Instinktet kafshërore brënda njeriut

Sipas neuropsiqiatrit Reinhard Haller (25.09.1951), nga natyra, të gjithë njerëzit janë të dhunshëm, "kafshërorë". Në princip, tek çdo njeri fshihet potenciali i dhunës, edhe nëse shumica e tyre nuk e shfaqin kurrë.

Sa për qind e popullsisë e shfaqin dhunën gjatë jetës?

Sipas filozofit Rudolf Haller (1929-2014), rreth 12 për qind e popullsisë, e bëjnë veten të denueshëm, si dhunues, të paktën një herë, gjatë jetës.

Vetëm kaq?

Psikologu i kriminalistikës, amerikani Joe Navarro, mendon se shifra e errët, është shumë më e lartë nga ajo që thotë Haller. Një gjë të tillë, e pranon edhe vetë

Haller.

Sa është kjo shifër!? Nuk dihet, duhet të jenë shumë nga ata që e shfaqin „kafshërorë“ e tyre në jetën private dhe sociale. Ai mendon se, rreth 60 për qind e rasteve të përdorimit të dhunës, nuk denoncohen, dhe autorët nuk dënohen kurrë. Rastet më të shumta janë ato të dhunës në familje, brënda katër mureve.

Brënda çdo njeriu, fshihet i ashtuquajtur i instinkti i moralit. Mendohet edhe „bllokuesi“ i instinkteve kafshërore. Funksioni i tij është, mbajtja e njeriut në gjendje ekuilibri socioal. Në ligj nuk njihet. Për vrasjet jashtë luftës, është shumë i fortë. Ai që vret dikë, i duhet ta kapërcejë këtë instinkt, ta thyej këtë „bllokues“.

Megjithatë, instinkti kafshërorë i hakmarrjes dhe gjakmarrjes, shpesh e mund atë. Nëse ky instinkt i moralit, „bllokuesi“ i instinkteve kafshërore, nuk ndërtohet apo dëmtohet që në fëmijërinë e hershme, vështirë se mund të ndërtohet ose riparohet më vonë.

Tek njeriu, asgjë nuk ndodhë rastësisht. Të gjithë njerëzit janë „pushkë e mbushur“ por, jo të gjithë e tërheqin këmbzën.

Sipas principeve të moralit, të gjithë njerëzit mësojnë kontrollin mbi vetveten dhe sjelljen humane me të tjerët. Që në fëmijëri këshillohen dhe trainohen për të mposhtur dhe sunduar impulset kafshërore.

Por, jo. Jo të gjithë ia dalin. Dikujt i „shkrepë pushka“, dikush e „shkrepë“ me dashje, dikush tjetër me paramendim. Dhe... dhuna nuk heshtë, pushka nuk ndalet

Përse ndodhë kjo barbari sociale?

Haller thotë se janë disa faktorë, që i zgjojnë nga dremitja, dhe i nxisin instinktet kafshërore, brënda njeriut.

Sipas tij kryesorët janë: Edukimi, genetika, dhunimi, alkoholi dhe droga.

Në një rast po bisedoja me prindërit e një djali, në moshën 24 vjeç. Djali, që në moshën 14 vjeç, ishte futur në rrugën e krimit. Në moshën 16 vjeç kishte kryer një vrasje dhe ishte denuar 12 vjet heqje lirie. Megjithatë, nuk tregonte asnjë shenjë pendese, dhe as korigjimi. Në vendin e vuajtjes së denimit, ai ishte koka e organizimit të dhunës dhe ligësive, mbi të tjerët. Gjatë bisedës, nëna kishte ulur kokën dhe ofshante, e mbytur në lot. „Unë ia kam bërë haram gjirin tim“, tha ajo duke qarë me dënesë. Babai, dikur e „shkrepë“ koburen: „Po, veç e ka baba trim“, tha ai, dhe qeshi vesh më vesh, shumë i lumtur, nga kënaqësia që ndiente

Poezi nga Poetja nga Peja Kumrie Shala

TRI HERË GJENERAL

(Në vend të një lapidari për heroin e dy kombeve,
Bekim Berisha - ABEJA)

Nuk desha të shkruaj më,
Shpirti po dhemb
Si plaga kripën,
Po nuk munda të mos shkruaj edhe për ty, Bekim!
Për ty po dhemb kjo plagë e rëndë,
Edhe atëherë kur të lanë në një lëndinë,
Asnjë pishë, asnjë man s'ta mbollën te gurvarri,
He, burrë i dheut!
Deshën të të përcjellim edhe fshehurazi në banesën e fundit,
menduan se s'ka kush të flasë për ty,
Se të zhduken amanetin, trimrinë, fitoren,
Të gjitha të mirat që i solle vendit tënd, Bekim!
Heu, he trimi!
Nuk të ngritën në piedestal,
Asnjë shtatore në këmbë,
As edhe një rrasë me mbishkrimin:
"Dëshmor i shteti të Kosovës!"
As këtë nuk e shkruan për ty, ABE, Bekimi ynë!
Menduan ta shlyejnë historinë tënde,
Të zhdukim trimërinë tënde, burrërinë,
Të të harrojnë të gjallë e të rënë,
O jo, ore burrë,
Në Graboc linde e u rrite,
Vendlindjen s'e korite,
Të gjithë Kosovës fytyrën ia ndrite,
Vit për vit, shteti kroat, komandantë e gjeneralë
Të mbulojnë me nderime e lavdi,
Të kanë shpallur hero të kombit të tyre,
Shteti yt të la anash!
Pse, he burrë!
A pse e deshe shqiptarin aq shumë?
A pse ishe një furtunë?
A pse frikën ia fute armikut?
A pse preve kokat e çetnikëve?
O trimi ynë, luftëtar i lirisë, hero i kombit tonë!
Nuk të harron Açareva,
Nuk të harron Drenica,
Nuk të harron Peja,
Nuk të harron Shqipëria,
Po as Juniku, Dardania hiç e hiç,
Për ty do të shkruajë historia,
Një herë në një mijë vjet një kësi burri vështirë se lind,

Ti linde në këtë anë,
Skënderbe për të luftuar për mëmëdhe.
Ti Bekim Berisha, o Abe!
Do të kujtojë gjithë shqiptaria sa te rrojë njerëzia,
Lum vendi ku ke lindur,
Lum nënlokja që të rriti,
Shqiptarisë fytyrën ia ndrite.
Po ç'të duhet ty shtatorja e shtetit tënd,
Ta ngritin çlirimtarët e rrejshëm,
Komandantët që kanë komanduar krimin,
Ti veten ke ngritur në piedestal
Tri herë ishe gjeneral,
Me shtatë gjuhë, ashtu si i fole dje lirisë,
I flet dhe sot lavdisë,
Ishe thananik,
Por i fortë krejt çelik,
Strateg e vizionar,
Gjeneral e legjendar,
Në beteja e në furtuna,
Ferr e terr sytë të panë,
Bashkë me shokët që me ty ranë.
Por çfarë the ditën kur re?
Ti, shëndetligu i lirisë!
Ti, lapidari i lavdisë!
Ti i paharruari i historisë!
Ti ke folur me heshjen,
Heroizmi nuk do fjalë,
Gjak do, sigurisht ke thënë,
Ditën kur ke rënë.
Ti shkosh hero atdheut,
Mund të kesh menduar, ABE!
Ashtu si porositi legjenda Skënderbe.

U MBROJT PLISI, FISI E LISI

Nuk lejuat që fisi e plisi të jenë pa zot
Pa tokë e pa kokë

Edhe pse është kohë tmerri
Dija nuk vlerësohet
Se ajo përbuzët e harrohet

Aty ku nuk ka dije s'ka respekt
S'ka njerzi
S'ka organizim e as shtet

Jo nuk ka as lumturi
As pushtet dhe as dashuni

Do të punoj fort për inate
Çdo sukses do ta fus në punë

Vlerat dhe kontributin e të parëve të mi
Nuk do e humb askund
Me punë do e mund çdo sfidë e furtunë
Edhe nëse shpirtin për të do e humbë

Nuk do ta lë të shkoj si qeni në rrush
Ta mbështjellin ta bëjnë tarabush
Do e vëjë në vijë e në pah
Ku njohën llagapin e troallin

Prej Sarajave të Bardha e në derë Stambolli

Emri i fisit Shaljanë e dera
Ali Dushit, Bellagji
ku e mbrojti plisin e fisin
Krajli e mbreti ia kanë pas zili
Luftuan për vatan e për shqiptari

Shaljanët ky fis malësori
luftuan për A'të e fe
Tafë Avdyl Shala kishte
pas ba be
Nuk do ndërroj kurrë këtë fe
E as plisin s'do e lë
Nëse është nevoja vdes më të

Do e mbroj me krenari
Këtu i thonë shqiptari
Jo krajli e as shkini

Mos t'i humbim rrënjët e lisit e të plisit
T'i jetojmë me fis e plis
E lisi i vjetër në oborin shekullor
Më rrënjë shtatëpash nën tokë
Dhe lidhur me shokë e me plis në kokë

Se këtu lindi fisi e ...
E me fanatizëm e rujtën lisiin
Më krenari e me jetë e mbrojtën plisin.



◀ për „trimëritë“ e djalit të vet.
Gjithçka ishte e qartë, ai nuk
dëshironte një djalë në shtëpi por,
një përbindësh, sipas moralit dhe traditës
se vet.

Në familje të tilla, fëmijët, që në fëmijërinë e tyre të hershme, mësojnë „fikjen“ e mekanizmit të ndjenjave. „Bllokuesi“ i instinkteve kafshërore, i programuar nga natyra, është dëmtuar ose nuk është ndërtuar kurrë. Ata mësojnë principin: kundërshtarit, ktheja dyfish, mos i le kurs. Dhe, gjithë jetën e tyre, janë „kobure e mbushur“. Ata ushtrohen si dhunues, autokratë, mbi të tjerët. Sipas psikologut amerikan, Albert Bandura (1925-2021) sjellja e keqe është rrjedhojë e të mësuarit të gabuar. Kjo vjen nga prindërit, shkolla, mjedisi dhe media. Eksperti kriminolog gjerman, Hans-Ludwig Kroeber thotë se, 70 deri në 80 përqind e kriminelëve janë rritur në familje të dhunshme ose, të desocializuara.

Por, jo të gjithë ata që kanë një nënë të vështirë, apo një baba „kafshërorë“, ose të dy prindët njerëz të desocializuar, bëhen kriminelë. „Delja e zezë“ mund

të dalë edhe nga prindër model, nga një vatër shumë paqësore, e panjohur për ligësi, dhe e painfektuar nga krimi.

Nga vjen kjo „delja e zezë“?

Diku në parardhësit, ka ekzistuar geni „kriminal“. Ky gen, sado që dremit, dikur zgjohet dhe, trashëgohet tek pasardhësit. Albert Einsteinin ishte gjeni. Ai kishte dy djem, njëri ishte njeri normal, tjetri me çrregullime mendore. Nga i mbiu gjenit „delja e zezë“ në shtëpi?

Kjo është trashëgimi genetike, sqaron Haller. Ajo dremitë diku, brënda njeriut, gjeneratë pas gjenerate, dhe dikur zgjohet, aty dhe atëher, ku askush nuk e pret. Është e pashmangshme, dhe shumë e vështirë, për t'i korrigjuar pasojat e saj, qofshin ato fizike, mendore apo të personalitetit.

Duket sikur njeriu i sotëm, psiq-ikisht, është po ai i para dhjetë mijë vjetëve. Thjesht ka modernizuar mjetet e luftës, duke i kthyer ato në vrasëse dhe shfarosëse masive dhe, asgjë më shumë. Kulturantropologjia amerikane, Margaret Mead (1901-1978) dhe psikologu Golding, tek dhuna gjetën një sëmundje por u ndanë në mendime lidhur me diagnozën.

Për Golding, dhuna ishte instalim gjenetik të cilin ne e kemi trashëguar nga të parët tanë. Civilizimin ai e mendonte si të vetmin ilaç të kësaj sëmundjeje, por civilizimi mund të mposhtë simptomat dhe jo të shërojë sëmundjen. Mead mendonte ndryshe. Ajo thoshte se dhuna është një sëmundje përhapëse të cilën e sjell civilizimi. Sipas saj, civilizimi ishte shkaku dhe jo ilaçi.

Shumë e njohur dhe e theksuar është kjo tek psikopatët, ata që mendohen tipat mjedis-helmues.

Tipi që vuan nga çrregullime të forta narciste të personalitetit, është i njohur si dhunues, poshtërues i të tjerëve, dhe shpesh vrasës serial.

Dhuna, gjithmonë, prodhon dhunë. Sipas psikologjisë, ai që dhunohet, do të dhunojë. Brënda tipit të dhunuar, formohet „principi“: Ashtu siç m'a kanë bërë mua të tjerët, do t'ua bëj unë të tjerëve. Shumë nga diktatorët, kanë përjetuar fëmijëri të dhunshme.

Njëri ndër ta ka qënë edhe Stalini. Ai, në fëmijërinë e tij të hershme, kishte përjetuar dhunë nga babai i vet, pijanec. Di-

kur ai tha: „Të gjithë ata që kanë pushtet mbi mua, më duken aq të rrezikshëm, sa dhe babai im. Nuk i duroj dot“. Dhe, vërtetë nuk i duronte. I vriste.

Alkoholi dhe droga, janë një faktor nxitës, në rrugën e kriminalitetit. Ato zgjojnë nga dremitja instinktet kafshërore tek individit, dhe shfaqet përbindshmëria.

Sipas Haller, smira, urrejtja, xhelozia, janë burimi i 60 - 65 për qind të krimeve kundër personit.

„Ilaçi“ kundër kafshërimit brënda njeriut, është gjetur. Ky është edukim, edukim, edukim!

Kryesorja është ndërtimi i vetëdijes tek fëmijët. Kjo mund të arrihet nëpërmjet tre faktorëve: Kohës, përkushtimit dhe dashurisë, thotë Haller.

Edukimi i fëmijëve duhet të fillohet me shkëputjen e fëmijës nga barku i nënës. Atë që nuk e mëson Koleci, nuk e mëson më Kola.

Prindër, mësojuni fëmijëve notin, mos u mundoni të thani detin!

Lekë Imeraj
shkrimtar, përkthyes, publicist.

REDAKSIA

Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:

DEDË PRENDAJ
New York

